

FUAT ÇELIKU

BIBLIOTEKA
SHTETIT

811-52

Ç 36

NE ÇADREN
E TRETË
NJË USHTAR
NUK FLE

Tregime



8Jlt-32
c 36.

FUAT ÇELIKU

NË ÇADRËN E TRETË NJË USHTAR NUK FLË

Tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TRE SHOKË

Detyra ishte plotësuar. Në Gj. nuk u doli aq shumë punë sa mendonin ata. Megjithatë difekti kishte qenë i rëndë. Tani e kuptonin pse zëri i komandantit të repartit kishte ardhur në kufjet e radiostacioneve që mbanin mbi shpinë aq i shqetësuar dhe i rreptë. «Nisuni në Gj. me çdo kusht. Cënohet gatishmëria luftarake. Pikë!»

Urdhëri ishte urdhër. Këtë që të tre e dinin, Ndoshta ishte e para gjë që kishin mësuar në ushtri. Po më tepër dinin ç'ishte gatishmëria luftarake. Nuk bëhej shaka me të. Akoma më mirë e dinte këtë Petraqi, që para një muaji shokët e kishin bërë për ujë të ftohtë.

Ylli, duke parë kohën e keqe, ishte nisur edhe vetë me të dy ushtarët për në Gj. Dhe tani që detyra ishte plotësuar, si Ylli dhe të dy ushtarët e ndjenin veten të qetë e të gëzuar, siç e ndjen veten çdo ushtarak në raste të tilla.

Si hëngrën me shumë shije ato që kishin marrë me vete, sallam, djathë e mish kutie, e ndjenin veten të çlodhur. Kështu që, pa iu tharë mirë djer-sa, u nisën përsëri. Këtë radhë drejt nënrepartit të tyre, në majë të malit. Me sy maja dukej fare afër, po ata vetëm për të zbritur kishin bërë pesë orë rrugë. Veç aparaturave kishin tani vetëm një

shishe konjak, gazetat që morën në Gj. dhe disa letra të shokëve. Ishte ora katër pasdreke.

Çizmet e lagura, që rëndoheshin në çdo minutë që kalonte dhe ngarkesa e rëndë mbi supe, bënë që pas një ore rrugë të merrnin frymë me zor. Era, pasi kishte shfryrë tërë natën dhe paraditen, e lodhur kishte pushuar disa orë si për të marrë fuqi. Po edhe errësira nuk ishte gjë e pakët. Ishte një natë e frikshme.

Megjithëse era frynte më pak, dëborra binte e dendur e me flokë të mëdhenj. Ajo u zbardhi sakaq rrobat, kokoret, aparaturat dhe armët. Vetëm letrat e gazetat nuk po lageshin në gjoksin leshtor të Kristaqit. Aty, në gjoksin e tij të ngrohtë, ishte edhe një letër për të nga nëna e dashur, nga i vetmi njeri më i afërt. Por s'ke mundësi të lexosh edhe një letër që të vjen nga nëna! Ai kishte vendosur ta lexonte i qetë. Se mund ta kishte hapur në Gj. Po, kur s'je midis të gjithë shokëve të tu të ngushtë, sikur s'e ndjen aq shumë atë ngrohtësinë e letrave që bien erë mall. Tani që po çante në krye me elektrikun e dorës të ndezur, ai mendonte se ç'mund të ishte shkruar në letrën e nënës.

Me siguri diku ajo do t'i thoshte se ai duhej më në fund të vendoste të fejohej. Që të gëzohej edhe nëna ç, të kishte një njeri pranë. Dhe me kë? Ai e dinte se letrat e nënës ia shkruante fqinja e bukur. Ai buzëqeshi. Ç'është e drejta atij i pëlqente ajo vajzë, se bashkë ishin rritur. Po i vinte rëndë t'i thoshte nënës. Ama edhe ajo, e ndryshonte shkrimin kur shkruante ato fjalë të nënës. Dukej që i dridheshin duart. Dukej që edhe ajo priste me ankth përgjegjen e tij. Po fundi, pse ajo vetë nuk shkruante dy radhë mu aty në letrën e nënës. Ç'ti thoshte?

«Unë të pres, Kristaq», ja vetëm kaq. Pastaj e dinte vetë ai si e qëndiste. Në mos ai, pse e kishte Petraqin? Bile edhe komandant Yllin do ta pyeste. E ç'të keqe kishte? Edhe komandant Yllit i vinin letra. Në kohën e lirë do t'ia thoshte, se nuk ishte budalla t'ia thoshte tani në mes të natës. «Komandant Ylli, më ndihmo të bëj një letër dashurie!.. He, he.. Ai e humbi ekuilibrin, po dora e fortë e Petraqit e tërhoqi. Elektri i shpëtoi nga dora dhe fluturoi në rrëpirë. Tani e kuptoi Kristaqi se ku kishte qenë.

— Kujdes, shokë, vëmendje këtu, nuk është ditë ! — tha Ylli. Ishte tepër errësirë. Rrugën e kishte mbuluar bora. Elektri, që mund të zbulonte ndonjë shenjë, kishte fluturuar poshtë dhe lëshonte një pullë të ndritshme.

— Do të ngatërrohem, — tha Petraqi.

— S'kemi as busull — tha Kristaqi.

— Më janë lagur shkrepëset — tha Petraqi. Ishte i vetmi në gjithë nënrepartin që pinte duhan.

— Të kisha një cigare! — tha.

— Ndaloni! — urdhëroi Ylli dhe doli në krye. Të shohim ku po shkojmë.

— Përpjetë, gjithnjë përpjetë — tha Petraqi gjysmë me shaka.

— Përpjetë, po ku do na nxjerrë kjo e përpjetë? — pyeti Ylli, duke u munduar që të dukej sa më i qetë.

Petraqi nuk dha përgjigje. «Ç'të bëjmë tani?» pyeti veten Ylli. Bora, nata, të ftohtët, lodhja, e përpjeta dhe, më e keqja, era që të mpinte fytyrën, ishin për ta kundërshtarë të fortë. Ja, tani edhe ecaja rrugë e pa rrugë.

— Sa kemi bërë vallë?

— Nja tri orë, shoku komandant — u përgjegj Kristaqi.

— Gabohesh, më pak. Po na duket më gjatë nga e përpjeta.

— Sidoqoftë, aty pranë teqesë duhet të jemi, shoku komandant.

— Ashtu mendoj edhe unë — ndërhyri Petraqi.

— Ta kërkojmë — propozoi Kristaqi.

— Të gjithë bashkë — tha Ylli.

— Po ç'na duhet teqeja? — u hodh Petraqi.

— Ne do shkojmë në nënrepart.

— Koha është egërsuar shumë, prandaj më mirë është që sonte ta kalojmë aty. Pastaj, shokët e dinë që jemi në Gj.

— Është e pamundur ta gjejnë teqenë. Ajo është mbuluar me borë.

— Do ta gjejmë, do ta gjejmë, Petraq — tha Ylli. Ylli e ndjeu se Petraqit po i humbte humori. Ishte gjë e madhe kjo. Kjo ishte dobësia e Petraqit, thyhej para vështirësive, sidomos në stërvitje. Këtë e dinin të gjithë. Sa herë e kishin kritikuar... I pari Ylli. Prandaj edhe tani u mundua që në këtë rast zërin ta kishte të sigurt, që t'i krijonte besim ushtarit.

— Të shkojmë të tre djathtas — tha Ylli.

— Do të biem në ndonjë humnerë, s'i dihet vendit — tha Petraqi.

— U trembe ti? — pyeti Kristaqi.

— Kush të tha që u tremba? — u nxeh Petraqi,

— Epo atëhere lëri këto.

— Jo, Kristaq, nuk është keq të diskutojmë. Të sigurohesh, nuk do të thotë të trembesh.

Kristaqi nuk u përgjegj. Petraqi pa me mirënjohje nga vinte zëri i Yllit. Asnjëri nuk e shihte

tjetrin. Po Ylli e merrte me mend pamjen e tyre. Nuk ishte e para herë që diskutonin kështu. Ai e kuptoi se Petraqi i erdhi mirë që komandanti mori anën e tij.

— Të zihemi dorë më dorë e të kërkojmë nga e djathta — propozoi ai.

Ashtu bënë. Ylli i pari, Petraqi i dyti dhe pastaj Kristaqi. Në fillim Kristaqi këmbënguli të ishte ai i pari, por Ylli tha:

— Po të varet Kristaqi në ndonjë rrëpirë, s'ka burrë që ta ngrejë. Bile, do të na marrë edhe ne pas.

S'dihet sa kohë kaloi, një orë, dy, tre, duke kërkuar në të majtë e në të djathtë të kurrizit të zbardhur të malit. Nocioni kohë kishte humbur. Mund të ishte koha kur në familjet e qyteteve e fshatrave tringëllinin pjatat ose kur hiri i zjarreve po shtohet.

Ata e ndjenin se ishin lodhur shumë. Dhe, kur e gjetën teqenë, s'kishin më fuqi të hapnin borën për të hyrë brenda. Yllit po i digjnin kyçet e gjunjve. Djersa i qe përtharë nga era që i binte me tërsëllëm mbi tërë trupin. Dy ushtarët pranë tij merrnin frymë me zor. Ai dëgjonte kërcitjen e rregullt të dhëmbëve të tyre.

— Të hapim borën — tha Ylli.

— Ta hapim — u përgjegj Kristaqi.

— Atëhere, o burrani! — çau errësirën përsëri zëri i Yllit.

Dhe ata filluan. Në fillim ngadalë sa iu ngroh trupi, pastaj më shpejt. Një kanal hapej drejt derës me dru të trashë ahu.

— Tersët! — tha Petraqi me zë fare të mekur. — Edhe dyert ters i kanë ndërtuar. Këtu po shoh që të hapen nga jashtë.

Ata e tërhoqën njërin kanat sa të nxinte trupin e Kristaqit dhe hynë brenda. Jashtë natyra ishte e egër, brenda ishte ngrohtë, thatësirë, rehat. Petraqi pati fuqi sa të hynte në dhomën e zjarrit dhe u shtri ku mundi.

— Nuk katandiset kështu ushtari, Petraqi — i tha Kristaqi.

— Duhet të ndezin zjarr — tha Ylli.

— S'kemi shkrepëse, janë lagur.

— Më mirë të flemë — tha Petraqi.

— Më parë të thahemi — tha Ylli.

Kërkoj mbi jashmak strallin, eshkën dhe masatin, që i mbanin për raste të tilla. Pasi fërkoj duart mirë e mirë për t'i ngrohur, filloi ti çukiste.

Kristaqi shkoi të merrte dru e shkarpa në korridor.

Me një gazetë ndezën llambën me poç të thyer. Drita e zbetë shpërndau një pjesë të errësirës.

— Po ky! — u çudit Kristaqi kur pa Petraqin që ishte shtrirë dhe nuk bëhej i gjallë.

— Po fle — tha Ylli.

— Do të ftohet.

— Të ndezim zjarrin mirë e ta zgjojmë.

Kristaqi nxori nga gjoksi edhe një gazetë tjetër dhe e futi nën shkarpa.

Zjarri u ndez sakaq dhe Ylli, sapo ngrohu pak duart, me mendjen të nënreparti, hapi radion.

— Oh, ç'bëra! — thirri Kristaqi, duke zgjatur duart drejt vatrës. — Iku letra e nënës, u dogj.

Ylli e pa zarfin që digjej e i erdhi keq. «Desh ta lexonte me shokët, të gëzohej bashkë me ta, mendoi Ylli. Aty nëna si gjithnjë, duhet t'i fliste për fqinjën e bukur». Aparati bënte zhurmë. Kishte shkarkime. «Bëra mirë që zbrita, Kristaqi do ta kish-

te vështirë në këtë kohë. Po edhe Petroja nuk është ankuar.

— Çohu, Petraj, çohu! — e tundte Kristaqi. Petraqi kërceu përpjetë.

— Aman, Kristo.

Kristaqi diçka i tha shokut në vesh dhe ai, duke parë nga Ylli, iu afrua zjarrit. Komandant Ylli lidhi antenën, vuri kufjet në vesh dhe rregulloi valët.

— Tirana, unë Tripi, Tirana, unë Trimi... — filloi të fliste. Por asgjë nuk dëgjohej. Vazhdoi kështu më se një gjysëm ore, por asnjë nuk përgjegjej. Hoqi kufjet nga veshët dhe iu afrua zjarrit duke sharë nepër dhëmbë.

— Ka shumë shkarkime. Duhet të lajmërojmë që jemi në teqe — shtoi pastaj duke parë nga ushtarët.

Por për çudi që të dy flinin ashtu të ulur pranë zjarrit. Ylli buzëqeshi me dashamirësi. Rrobat u avullonin. U koll fort. Kristaqi u hodh drejt e në këmbë.

— Më falni, shoku komandant!

— Zgjoje Petraqin dhe zhvishuni — urdhëroi Ylli.

Ata të tre u zhveshën dhe rrobat i mbajtën në duar për t'u tharë. Por Ylli e pa se, si atij edhe dy ushtarëve, lodhja e gjumi po u rëndonin qepallat. Ndaj urdhëroi që t'i varnin rrobat e të flinin.

— Po ju? — pyeti Kristaqi.

— Unë po rri roje, pastaj ju zgjoj ju.

— Jo, shoku komandant, roje do të bëj unë.

Ata u grindën ca dhe Kristaqi fitoi. Pas një ore ai duhet të zgjonte njërin nga të dy. Por

Kristaqi nuk zgjoi as njërin as tjetrin, derisa ata u ngritën vetë aty nga dreka e ditës së re, të çlodhur e të ngrohtë nga zjarri që Kristaqi s'e kishte lënë të shuhej. Për këtë Kristaqi mori një vërejtje të rëndë.

* * *

Kishin kaluar dy ditë dhe tufani s'po pushonte. Përkundrazi ai ishte i tillë, sa nuk mbahej mend prej disa vitesh. Kishin tridhjetë orë pa futur gjë në gojë. Çdo përpjekje për të hyrë në lidhje me nënrepartin lart qe e kotë. Ata lart mund të kishin ndërruar valën.

Kishte shkarkime të shpeshta elektrike. Ata po-thuaj ishin shkëputur fare nga bota. Vetëm përfytyrimi dhe mendimi i lidhte me të. Ndjaj secili më tepër mendonte se sa fliste.

Bora binte pa pushim. Komandant Ylli rrinte përmbys dhe shkruante e shkruante pa pushim në blokun e tij me kapakë të trashë.

Të gjithë ushtarët e dinin se ai ishte i fejuar. Edhe Ylli gëzohej si të tjerët, kur posta sillte letra. Edhe ai ishte në grumbullin e atyre që dëgjonin kur ndahej ajo. Ylli u fliste pa të keq për të fejuarën, si ishte njohur e si ishte fejuar.

Petraqi rrinte përmbys me duar në mjekër. Kristaqi pastronte automatikun e vet.

— Po zëmë myshk duke ndenjtur nën çati. Ç'bëjnë shokët vallë? — tha ai.

— Përballojnë stuhinë e stërviten — u përgjegj Petraqi.

— Pse i merr gjërat kaq lehtë ti? — kërceu Kristaqi.

— Harrova që ti ke halle të tjera.

— Çë?

— Që të propozojë komshija dhe letrën e përgjegjes ta bëj unë me komandantin.

— Ah, letra! . . — ndërhyri Ylli.

— Shoku komandant, ne po vrasim kohën kot — tha Kristaqi i skuqur vesh më vesh.

— E, mos e humb fjalën — tha Petraqi. Dhe e heq veten për trim, të rroftë forca që ke!

Ylli buzëqeshte duke dëgjuar Petraqin e duke parë Kristaqin se si turfullonte nga inati. Por mëdjen e kishte edhe te vërejtja e Kristaqit. «Po e vrasim kohën kot. Të nisemi? Po tufani vazhdon, rrugët nuk shihen, bora vete deri në brez e vende — vende të mbulon. Unë kam në dorë jetën e dy njerëzve. Duhet të matem kur të jap urdhëra. Po me shokët lart ç'bëhet? Të presim edhe sonte? Ç'të bëjmë? S'kemi lënë artikull gazete pa lexuar. Vetëm t'u bëj mësim atyre të dyve . . .» «Po sakaq hoqi dorë.» Nesër shohim e bëjmë mendoi. Iu afrua aparatit dhe hapi çelësat. Vetëm zhurmë. Koha atje vazhdonte të ishte e keqe e me shkarkime. Efektivi duhej të qe larguar në vendbanimin rezervë, duke lënë vetëm rojet. Këto i merrte vetëm me mend Ylli. «Nesër duhet bërë diçka. Këta nuk e bëjnë veten, por i griu uria, si edhe mua».

— Katër ditë pa bukë e ujë ndenjën — foli Petraqi.

— Në mes të detit.

— Pse, ky nuk është det?!

Ylli u mundua ta kapte fillin e bisedës, por nuk kuptoi gjë E ndjente veten të plogësht e të lodhur. «E ku jemi mësuar ne të rrimë orë të tëra shtrirë, e pa punë!» Mori përsëri lapsin, por sakaq e la. Ish-

te errësuar. Po i mbylleshin sytë. Kishte ftohtë. Kurse drutë kishte kohë që ishin mbaruar. Dëgjonte bisedën e dy ushtarëve dhe mendonte se ç'mund të bënte ai si komandant.

E nesërmja nuk solli asnjë ndryshim. Përkundrazi, ishte një ditë me mjegull që s'dihet se nga kishte vërshuar edhe brenda teqesë. Era frynte si e tërbuar. Bora binte e binte. Ylli rrinte i shtrirë në shpinë me sy nga tavani. Sekondat dhe minutat kalonin dhe tiktaket e sahatit të tij Yllit i vinin në veshë si tringëllima kambane. «Ikëm, ikëm», sikur thërrisnin ato.

Ora po i afrohej shtatës dhe prapë errësirë. Sa natë e gjatë, e mërzitshme dhe me barkun bosh! Larg njerëzve. Vetëm në mes të natyrës së egër, brenda një ish — teqeje dervishësh me hije të rëndë e të heshtur. Ja, Kristaqi merr frymë me zor. Gjithë ai trup do të ushqehet. Sa për të ftohtë nuk pyet fare. Po Petraqi? Mos vallë do të vijë një çast që edhe ai do të të thotë: «Tani mjaft më, s'durohet.» Si atëhere në stërvitejen e gjatë taktike. Si i janë ngulur në mendje këto fjalë të Petraqit komandant Yllit!

— Ç'do të bëjmë, shoku komandant? — kumboi në dhomën e ftohtë zëri i trashë si bori borige i Kristaqit. — Ky tufan nuk mbaron ndoshta tërë vitin. Këtu do të rrimë?

Po s'mori përgjegje.

— Ç'do të bëjmë, shoku komandant? — përsëriti Kristaqi.

— Ç'të bëjmë, Kristo? — tha Petraqi. — Të fluturojmë si shkëndia nga oxhaku e t'i japim dritë gjithësisë?

— Po lëri një herë këto shaka ti, njëlloj gjith-

një. Po bëhemi si ata besimtarët e ngratë që vinin gjer këtu t'i kërkonin mëshirë natyrës. Edhe ne prandaj jemi futur brenda.

— Dukesh — e ngacmoi Petraqi. — Dukesh se je besimtar, bile dervish që nga mjekra që të është bërë dy pëllëmbë.

— Shoku komandant... — u ankua Kristaqi duke lëvizur nëpër dhomë, që tani as zhurmën e aparateve nuk e duronte dot, se i gërvishnin nervat.

— Je në vete, ku të vemi? Apo të na përpijë tufani! — tha Petraqi i shqetësuar.

— Jo, mor, mos ki frikë.

— Mos do të bëhesh hero si Hekuran Zenuni ti, që të shkruajnë edhe gazetat?

— Hekurani ishte njeri me vullnet të hekurt që ne s'i vimë gjëkund dhe s'e bëri atë që bëri për të dalë në gazetë. Ai nuk ishte frikacak, po një ushtar që e ndjente detyrën — foli Kristaqi, këtë radhe shumë i mëzitur. E kishte lënë armën mënjanë dhe sytë ia kishte ngulur shokut, gati për të marrë përgjegjen e tij. Po Petraqi pyeti edhe ai i prekur.

— Pse kush është frikacak sipas teje?

Ylli u detyrua të ndërhynte.

— Asnjë nuk është frikacak — tha Ylli. Dhe vijoi: — Atëhere, çmendoni të bëjmë?

— Për mua, të nisemi menjëherë, — tha Kristaqi.

— Edhe kjo duhet parë. Kemi dobësi dhe ti je pa gjumë.

— Kristaqi është pa gjumë.

— Pse ti jo?

— Jo, sepse ky prap nuk më zgjoi mua.

— Ç'është kjo, Kristaq?! — u nevrikos Ylli.

— Thashë, do të bëjë heroizma.

— Jo — u përgjegjën me një gojë Ylli e Krista-
taqi. Po fjalinë e vazhdoi Ylli. — Nuk duhet marrë
kështu. Kjo është një shprehje e dashurisë për sho-
kun. Atëhere pusho ti, Kristaq, një herë.

— S'më vjen gjumë, — buzëqeshi Kristaqi
— Fli!

— I grinë zorrët, shoku komandant, aty e ka
mendjen — qeshi Petraqi. — Ku i ke ato pulat që të
dërgonte nëna muajt e parë?

Me Kristaqin bënë edhe shumë fjalë, por ai
nuk u bind të flinte.

— Çohuni! — urdhëroi Ylli më në fund.

Ushtarët brofën në këmbë.

— Pregatituni të nisemi!

Zëri i Yllit, që shpesh dukej si cicërimë zogu,
kishte ndryshuar. Ai ishte bërë i rreptë dhe i ngry-
sur. Fytyra mitake e komandantit qe vrejtur. Ajo
fytyrë që gjithnjë qeshte.

Ylli lëvizi një çelës që bëri «praf» dhe zhur-
ma e aparateve pushoi. Këtë të tre e ndien menjë-
herë. Ndërlidhësit s'rrojnë dot pa atë zhurmë. Ajo,
kur janë në male, i lidh me njerëzit, me botën e
madhe të qyteteve e fshatrave, me zhurmën e re-
parteve e me atmosferën e parqeve e të rrugëve.
Tani që zhurma pushoi ata e ndjenë menjëherë
vetminë. Larg botës së madhe e të bujshme. «Të mi-
rën e ndjen pasi të ikën», mendoi ai. Edhe Ylli
mendonte. Ja, veç të tjerave, ai tani ishte larg Mi-
mozës së tij.

Ajo mbase tani shënonte leksionin. Mbase shë-
nonte në fletore emra malesh, por jo atë mal ku ngji-
teshin ata.

Ai nxori shishen e konjakut dhe njëri pas
tjetrit pinë gllënkat e fundit. Konjaku të ngroh në

kohë të ftohtë e, kur pi dy gllënka më tepër, të shtyn të ecësh më shpejt.

Ylli qeshi. Iu kujtua përsëri e fejuara. Edhe ajo kishte pirë një herë konjak sa i kishin dalë sytë. Ishte dita e parë që prindërit e kishin lënë të lirë të shkonte në mbrëmje me Yllin pa i caktuar orar. Ata kishin dëfryer shumë në Pallatin e Ushtrisë. Bile, ajo kishte pirë me gëzim një shishe të tërë me birra. Ndoshta nga lumturia, nuk ndjeu se piu. Ajo pra ishte e gëzuar atë natë në mes shokësh e shoqesh të Yllit, disa prej të cilëve i shihte për herë të parë. Erdhi një shok tjetër i Yllit.

« — Ylli, ti je shok i keq. Asnjë gotë verë nuk na dhe. Po të isha fejuar unë, do mbytyja dynjanë sonte. Elbetë. Njeri i pambukut ti... »

Ylli e njohu me Mimosën dhe u kthye nga banaku, po shoku i vuri dorën në sup.

— Aaaa, tani është vonë shumë.

Sakaq erdhi kamerieri me dy gota.

Shoku i tha: — Me shëndet, u trashëgoftshi na falni shakatë — dhe u largua. Po Mimoza nuk e mori veten. I merreshin mendtë. Pastaj ata të dy dolën. Era e mbrëmjes me aromë lule bliri ia shtoi më tepër turbullimin. Sytë me lot qeshnin, kurse buzët e kuqe e të freskëta dilnin përpara si të një fëmije.

— T'i s'duhet ta pije atë konjak të mallëkuar, — tha ai.

— Të dua, Ylli, shumë — pëshpëriti ajo dhe mbështeti kokën e vogël në supin e tij.

Kështu ata ecën pa folur deri te shtëpia e saj. Kur do të ndaheshin ajo i tha:

— Pse të thonë ty, Ylli, njeri i pambukut?

— Dhe fluturoi brenda duke përplasur fort dyert, që Ylli i dëgjoji deri jashtë. Fjalët e së fejuarës

iu ngulitën si thikë në tru. «Sa përshtypje i paskan bërë!...» mendoj. Ai e dinte se Mimoza ishte një vajzë e ndjeshme dhe i donte njerëzit me natyrë burrërore, të prërë në fjalë e në vendime. «Kjo më pëlqen te ju ushtarakët, Ylli, kurse ti je si një shqerrë, i butë». Ylli në këto raste premtonte se, kur të martoheshin, do të thyente shumë pjata. Por ajo ankohej se si nuk e kuptonte. Të silleshe ashtu si arrogant s'do të thoshte se ishte burrë. Dhe Ylli gjajesej së qeshuri. Që atë natë ajo kishte filluar t'i fillonte kështu fjalitë...

— E, mo i pambuktë...

Po Ylli vetëm buzëqeshte...»

Kristaqi u koll për t'i tërhequr vëmendjen, po Ylli nuk i ndërpreu mendimet. Që nga ajo natë kishte kaluar më se një vit. Mimoza tani ishte larg. Sidomos tani që edhe aparatet e radiove nuk punonin më. Kishte ardhur një ditë që ai, Ylli, «Njeriu i pambuktë», kishte kërkuar të vinte këtu, në këto male të ashpra. Kjo i kishte çuditur të gjithë, edhe Mimosën.

«— Keq më vjen, s'do mend. Do të shihemi më rrallë — i tha ajo.

— Që të mos më thuash më «i pambuktë» — kishte thënë ai dhe e kishte puthur fort...»

Ai mendonte. Dy ushtarët e shikonin që mendonte dhe nuk i flisnin. Po Ylli u përmend dhe pyeti:

— Gati, shokë?

— Gati — u përgjegjen me një zë të dy ushtarët. Po Ylli u përpoq të dëgjonte atë të Petraqit. Edhe zëri i tij i erdhi në veshë i sigurt. Ylli buzëqeshi dhe shtyu me forcë derën e blokuar nga borra që, për t'u hapur, kërkoi forcën e krahëve të të treve. Pas pak ata ishin jashtë.

— Bukur, — tha Kristaqi — koha është tamam për të marshuar.

Mjegulla ishte holluar. Mund të shikoje disa metra përpara. Era kishte pushuar e bora binte fije-fije gati si shi. Por retë qëndronin gjithnjë të varura e kryeneçe si një vello zie mbi majat thikë të maleve. Në fillim borën e çante Petraqi. E vendosëm që të ndërroheshin në çdo dhjetë minuta. Bora vinte deri në mes. Ishte e butë fare dhe këmbët të fundose-shin deri në tokë. Yllit i vinte deri në gjoks. Që në ndërrimin e dytë. Petraqi pyeti tri herë:

— U mbushën dhjetë minutat?

Kristaqi nuk fliste. Edhe kur i vinte radha të ndërrohej e hiqte Petraqin për xhakete dhe i dilte përpara. Pastaj ecte vetë dhjetë minuta, pesëmbëdhjetë, derisa Ylli që e kishte radhën pas tij, të bërtiste fort e ta urdhëronte rreptë. Retë u hapën andej nga perëndimi dhe u duk një copë qiell. Të treve u ndriti fytyra. Por rruga u bë më e vështirë, bora nuk mund të çahet më.


— Ta lemë këtë rrugë e t'i biem drejtpërdrejt — tha Ylli.

Ata e dinin që ajo faqe e pjerrët mali mbante më pak borë.

— Më mirë e përpjeta se thellësia e borës, — tha Petraqi, duke ecur këmbadoras në shpat të malit.

Po më lart bora kishte ngrirë dhe, sapo Petraqi kishte bërë disa metra, rrëshqiti poshtë duke marrë me vete dhe dy të tjerët, që ishin prapa tij.

Qëndruan të bënin pesë minuta pushim e të merrnin një vendim. Dorezat në duar dhe kokoret në kokë u kishin ngrirë.



— Të çajmë akullin për të vendosur këmbët — tha Ylli. — Mirëpo duart... — Dhe ai nxori para duart e tij të ngrira.

— Unë i lëviz mirë gishtat — tha Kristaqi.

— Nxirr thikën atëhere.

Dhe ata filluan ngjitjen. Hapnin gropa me thikë dhe vendosnin këmbët e duart. Në trup ndjenin zagushi, në fytyrë e këmbë të ftohtë. Ngjiteshin dhe prisnin në çdo çast të rrëshqisnin. Ata u ngjitën këmbadoras në «Kurriz të kalit». Kështu quhej ai vend, pasi i ngjante çuditërisht kurrizit gjigand të një kali. Ishin në majë të malit. Sa rrugë kishin bërë? Shumë. Po binte errësira. Ata u ulën. Ishin të gëzuar. Tani nuk do t'u pritëshin gjunjët e nuk do t'u merrej fryma si në atë të përpjetë. Po ku i dihet natyrës. Ndjenin një nevojë që të rrinin aty, një orë, dy. Të shtriheshin, të dremisnin. Po Ylli u ngrit.

— Edhe dy orë rrugë, me dhëmbë do t'i hamë — tha me zë gazmor.

Dy të tjerët u ngritën si me përtesë.

— Rruga tani është e drejtë — tha Petraqi.

— Edhe bora nuk duhet të jetë e thellë, se e përulan era — shtoi Kristaqi.

— Kaluan rreziqet...

Atë çast, kur po mendonte secili për hesap të vet se kishin shpëtuar dhe për t'u ngrohur po përplasnin duart me njëra-tjetrën e këmbët pas borës, ata ndjenë mbi krye një erë të ftohtë, të befasishme, një mjegull që u derdh nga qielli e i mbuloi krejt. Ata panë se si menjëherë po humbnin shoku-shokun nga sytë. Pastaj erdhi një erë e fortë, që Yllit i shkuli kokoren e ngrirë pas kokës e ia flaku tutje në hon.

— Ç'u bë kështu?! — thirri Ylli.

— Tufan — bërtiti Petraqi. — Të nxitojmë.

— Shtrihuni! — urdhëroi Ylli.

— Tufan i mallëkuar! — shau Kristaqi.

Ata e njihnin mirë ç'ishte tufani. E dinin se sa vazhdonte ai. Ylli e ndjeu veten fajtor. «Natyre e poshtër!» mendoi. Po pastaj kujtoi se sa herë e kish-te admiruar natyrën e bukur. «Po të isha te dritarja e shtëpisë, do të më mahniste kjo egërsi e natyrës», mendoi sërish. Eci këmbadoras, me gjunjë e pëllëmbë.

— Shoku komandant, ku je! — thirri Kristaqi.

— Urdhëro.

— Jo andej, këtej, kapuni pas nesh.

Ylli pa ditur ishte nisur drejt honit.

Ata ecnin këmbadoras. Pa folur, me kokën të ngulur në borë. Ata ishin në qendër të ciklonit të pamëshirshëm.

— Ndal! — thirri Kristaqi. — Po biem në hon.

Kishin kaluar në anën tjetër të kurrizit të malit. U kthyen njëri pas tjetrit, pa u parë, por duke ndjerë praninë e shoku-shokut si një gjymtyrë të vetën, ende të fuqishme.

— Të kërkojmë piketat — u kujtua Petraqi.

— U, piketat!.. — u gëzua Kristaqi. Rruga që aty e deri në nënrepart ishte me piketa prej druri, që tregonin drejtimin. Ata kërkuan rreth e qark.

— E gjeta, e gjeta! — tha Petraqi.

Ai kishte zbuluar vetëm majën e një druri të rrumbullakët të fshehur në borë.

— Nisemi — tha Ylli.

— Po nga, majtas, djathtas, para apo prapa?

— Të gjejmë piketën tjetër.

Ata u nisën këmbadoras në dy drejtime, para e prapa, po piketën tjetër e gjetën nga perëndimi. Po ata nuk e dinin këtë!

— Po sikur të jemi nga perëndimi?

— Në të kundërtën jemi. S'e kupton ti që këtej është tatëpjetë?

— Kthehuni! Drejt piketës tjetër! Pas meje!
— urdhëroi Ylli.

Ata u nisën. Era e akullt e përzier me borë u rrihte mbi fytyrë. Antenat e holla të të dy radiostacioneve në kurriz të ushtarëve, tundeshin e hallakateshin si të shastisura nga era. Ushtarët pothuajse e kishin harruar fare peshën e tyre. Për ta, ato radiostacione të rënda ishin bërë si rrobat e trupit.

Këmbadoras, këmbadoras në drejtim të nën-repartit. Dy ushtarë e një oficer. Tre shokë. Kristaqi në krye. Ai mernte frymë thellë. Sikur të ishte vetë era që shfrynte e vërshëllente. Sa rrugë kishin bërë deri atëhere? Ndoshta një orë. Cikloni i rrotullonte minutat mbi kokat dhe trupat e tyre. Dhe ata rrinin aty për një kohë të gjatë. Torturuese. Ja që ka raste kur minutat e jetës sate të duken torturuese. Ndoshta ishin pranë «Shtegut të Jauptit». Po, po, aty ishin. Edhe një orë rrugë. Vetëm një orë dhe përsëri jeta do të rridhte me minutat e saj të gëzuara. Mes shokësh. Pastaj tufani do të pëshonte dhe nëpërmjet antenave do të vinte zhurma e botës së madhe, e shokëve. Por ja që këtë gëzim Kristaqi nuk po e ndjente më. Atij iu errën sytë. Iu errën fare. Edhe trupi iu mpi. Duart e tij të ngri-ra. si putra ariu, nuk bënë dot më tej.

— Ec, Kristaq... Kristaq...

— Unë nuk eci dot përpara...

Ylli doli në krye. Pas tij Petraqi. Kristaqi mbeti në fund. Kristaqi mbeti prapa, prapa. Ata i bënë dy lëvizje më tepër se ai. «Kanë kujtuar se thashë që nuk çaj dot në krye». pati fuqi të mendonte. Dhe thirri:

— Unë nuk eci dot fare...

Dy të tjerët shtangën si një makinë që frenon befasisht. «Nuk eci dot fare!» Ç'është kjo? Ata gulconin me fytyra më tepër në borë se sa jashtë. Me duart e këmbët brenda saj, të ftohta, të drunjtë. Pa fuqi, përveç se të mendonin për fjalën «përpara». Po ja që njëri e kishte lënë edhe këtë fjalë... Ishte lodhur më i forti...

— Ti, vëlla, u lodhe, po ne e kemi fajin — tha Petraqi duke i shkuar pranë.

Mendimet e tjera nuk ia tha me zë.

— Ti bëre rojë tërë natën, ti je pa ngrënë.

— Nuk mundem... — tha Kristaqi me kokë në borë. — Shpëtoni ju. — Petraqi sakaq ngriti trupin i egërsuar dhe e ngjeshi grushtin, aty ku duhej të ishte fytyra e shokut. Një grusht i fortë, aq fuqi sa mund të kishte grushti i trupit të drobitur të Petraqit. Një «oh».

— Me kë flet kështu, me kë? — ulëriti Petraqi. — Ç'jemi ne që të ikim, ç'jemi? Këtu do të vdesim të tre, po qe nevoja.

Koka e Kristaqit u ngrit pak mbi shtresën e borës. Ylli i kishte vënë dorën mbi supe Petraqit. Ai i kuptonte fjalët e dy ushtarëve, dëshpërimin e tyre.

— Mos u dorëzo, Kristo — i tha butë-butë.

— S'mundem.

— Kristo ti që je më i forti ndër ne të gjithë!? — tha Petraqi.

— Jo.

— Kristo, ngreje kokën. Nuk katandiset kështu ushtari i Ushtrisë Popullore. — u ngrit përsëri zëri i Yllit.

— Më fal, komandant!

«Ama shpirt ka ky komandanti! I vogël, po i fortë. Pale të kishte trupin tim».

Ai u mundua ta ngrinte edhe më kokën. Lotët i ngrinin në mollëza. E egër ajo fytyrë. E dëshpëruar.

— Eja, se na presin shokët tanë të mirë.

— Edhe të tjerët... edhe nëna ... edhe fqinja e bukur...

Kristaqi e kishte ngritur përsëri kokën dhe ecte këmbadoras. Ata deshën ta ndihmonin, por nuk mundeshin. Edhe ata pak fuqi kishin, shumë pak. Po Kristaqi nuk mund të ecte. Ata hodhën duart shkopinj mbi supet e tyre dhe filluan të zvarriteshin vetëm më gjunjë.

— Do shkojmë te shokët...

— Do shkruajmë letër...

Një... dy... një... hop... d... Pushim. Sa gjunjë kishin hedhur mbi borë?

Po të çlodheshe, ikte jeta. Një minutë në vend, të mpihej krejt trupi. Dhe as shokë, as miq... Natë dhe tufan. Natë dhe bardhësi. Borë dhe gjurmë gjunjësh. Kush e dinte se kush i linte këto gjurmë jete në atë majë mali? Kush vallë në banesat e ngrohata të qyteteve e fshatrave dinte për këta tre shokë? Kush mund ta dinte se si u zhdukën ata të tre pa lënë gjurmë? Prapa i fshinte bora. Përpara s'kishte. Kishte gjurmë vetëm nën gjunjët e tyre.

Kishin mbetur pranë një pikete. Pa fuqi. Përmbys. Kristaqi me krahët mbi supet e tyre. Po gulçimat vazhdonin e këto tregonin jetë. Sa kohë kështu? Një sekondë, dy, dhjetë, njëzet... Yllit iu duk një jetë e tërë.

«Ti je komandant, ç'bën?». Ylli kërceu përpetë, drejt e në këmbë me gjunjë të thyera, me grushte të shtrënguara.

— Çohuni, çohuni! — thirri.

Dhe qëlloi mbi kurrizin e të dy ushtarëve me grushtin kallkan.

Edhe Petraqi brofi në këmbë. U pa sy më sy me komandantin. Ishte shenjë falenderimi. Ata e ngritën Kristaqin dhe e tundën.

— Ku jemi?

— Afër patateve.

— Qëllo me automatik.

«Tani duhen të dëgjohen krismat», mendoi.

Petraqi bëri shumë lëvizje derisa hoqi automatikun. Me dhëmbë e uli sigurocën. Hoqi dorezat përsëri me dhëmbë. Futi gishtin e madh që kishte ngrirë më vete nga të katër të tjerët dhe e futi në komandantin e këmbës së shkrepjes. E shtyu prapa. Një karkatore me vërshëllima që i mori era.

— Mbase na dëgjojnë shokët.

Kristaqi u përmend.

— Ç'është?

— Qitje qeshi Petraqi. — Çdo predhë në shenjë.

Ata pritën se mos dëgjonin të shtënat e përgjegjes. Por jo. Të shtëna nuk dëgjuan. Ata ishin gozhduar në vend. Po ç'prisnin? Mëshirë nga koha?

«Ti je komandant, ti duhet të bësh diçka. Ti ke në dorë jetën tënde dhe të shokëve. Vepro. Me guxim. Vepro, vepro. Lëviz, vepro...»

— Petraqi, vëlla. Duhet një vendim.

— Urdhëro.

— Ke fuqi?

— Kam, si s'kam — dhe drejtoi gjoksin.

— Të lumtë!

Petraqi buzëqeshi i gëzuar përpara Yllit të vogël. Ishte një lavdërim nga komandanti. Dhe ai komandanti nuk të lavdëronte kot. Këtë e dinin të gjithë.

- Kristaq, o Kristaq.
- Urdhëro.
- Ke fuqi?
- Kam, si s'kam.
- Nuk je kot më i miri ndër ne ti.
- Falem nderit!
- Duhet bërë diçka.

Ylli kapi me dhëmbë kopsat e peliçes së Kristaqit dhe i këputi. Futi të dy duart dhe nxori gazetatat me letrat. Në gjoksin e komandantit u futën gazetatat.

— Petraq, unë po iki. Ju duhet të lëvizni. Mos harro. Lëvizni. Mos ia humb jetën shokut, Kristaqit tonë.

— Të shkoj unë, komandant?

— Po munde... shko.

— Jo, jo shkoni ju... — ndërroi mendje Petraqi. Kushedi ç'mendoi. Po ajo «shkoni» ishte e dhimbshme. Po sikur ai të mbetej pak më tej? Petraqi kafshoi gjuhën. Po ai nuk pati fuqi ta ndalonte komandantin. Ndërsa ai humbi në errësirë. Një errësirë e gjatë e gjatë, deri në mëngjezin e ditës së re.

— Të lëviz, të lëvizë edhe Kristaqi — tha ai. — Kjo është detyra ime — mërmëriti nëpër dhëmbë...

Kurse Ylli u nis. Ai që deri atëhere s'kishte pikë fuqie. Nga sytë i dilnin lot. E lotët në çast ktheheshin në kristale bore. Në vend të vetullave dy gisht akull. Po kjo ftohtësi e jashtme nuk ishte në brendësi të tij. Kishte vapë brenda në trupin e tij. Edhe kur ra, pas disa minutash, prapë i ngrohtë ishte. Po sytë rreth e rreth me akull, ata sy të vegjël e të qeshur, iu mjegulluan. Ai u për-

plas mbi borë dhe kapakët e syve u mbyllën. Tani gjithkund bardhësi. Mbi shkëmbinjtë në hone, në ajër, në pemë, mbi tokë mbi rrobat, mbi trupin e tij. Gjithshka e bardhë, e bardhë. Si një dritë verbuese. Ç'kënaqësi! Sa gjë e bukur! Po pse sendet e humbën trajtën e tyre të mrekullueshme? Pse ndërtesa e nënrepartit, aty më lart, u shtrembërua? Kjo ishte fytyra e Kristaqit dhe e qeshura e Petraqit?

Ai brofi dhe dy njollat e zeza në fytyrë u dukën përsëri. I përplasi fort qerpikët.

— Gjumi? Jo gjumë thirri ai me zë.

U ngrit në këmbë. Dhe vuri re se nuk po frynte si më parë. Por prapë frynte. Frynte dhe vërshëllente. Ai vështroi rreth e rrotull. Oh, «Shtegu i Demkos!» U gëzua.

— Kristaq, Petro, erdhëm — thirri ai, po me vete. — Erdhëm. — Ai e dinte, kishte edhe pak minuta rrugë. «Po ç'bëhen ata të dy? Po sikur Petraqi... Jo. Petraqi këtë radhë do të qëndrojë. Sa pak i njohim shokët ndonjëherë. Pa e parë shpirtin e tyre. Petraqi nuk do të dorëzohet. Ai ka në dorë dy jetë».

Yllit i shkoi mendja të qëllonte me pistoletë. Hoqi dorezat me dhëmbë. Ato kishin ngrirë dhe kishin marrë formën e duarve. Dhe ashtu të ngrira, si dy duar të prera, ranë përdhe. U mundua ta nxirrte armën, por duart s'i komandonte dot. Pistoleta mbeti në këllëf.

«Sa keq! Ata do të dëgjonin». Ai shikoi përpara. E merrte me mend ku duhej të ishte ndërtesa. I dukej se, sikur të zgjaste dorën e tij të tharë, do ta kapte atë, kaq i madh iu duk vetja. Gjoksi iu gufua. Pistoleta kishte mbetur pa këllëf. duart e drunjta kishin mbetur pa doreza, kurse ai ishte rritur.

«Përpara, Ylli, përpara!» urdhëroi veten. Dhe filloi përsëri këmbadoras, se nuk e mbanin më gjunjët. Ai nxitonte ashtu i madh, siç e ndjente veten. Nxitoi edhe më tepër. Iu duk sikur u bë erë. Po në të vërtetë eci si zakonisht. Po ta shikonte një njeri normal atë lloj ecje, do të nevríkosej. Kurse ai ishte aq i kënaqur.

«Ja, erdha. Ata shpëtuan. Ja, erdha. E ç'është kjo rrugë? Një shëtitje me Mimosën që nga komiteti deri te dyqani Nr.39 i zarzavateve, aty ku bënim takimet. Sa shpejt kalonin ato shëtitje! Aty prapa dyqanit putheshim dhe ktheheshim. Edhe ndërtesa e nënrepartit tonë është si ai dyqani. Ndaj do ta bëj shpejt. Shumë shpejt... Dhe aty do të puthem me shokët. Dhe do të shkojmë të gjithë me vrap drejt Kristos e Petros. Të fuqishëm, të palodhur. Këtu duhet të jetë roja... Ja, erdha, ja, erdha...»

Ai ra, kurse roja, kur po matej të thërriste: «Ndal!» bëri «oh». Po nga vendi nuk lëvizti. Ai nuk e njohu komandantin e tij. Ishte natë. Nga brenda vrapuan shumë shokë dhe më vonë, kur mori vesh roja, kafshoi buzët dhe fshiu lotët...

— Jo mua, Petraçin, Kriston — bërtiste Ylli në kllapi.

— Shkuan, shkuan, shoku komandant — thoshin ushtarët që kishin mbetur në ndërtesë.

— Po vijnë?

— Po vijnë, shoku komandant...

Duart ia kishin mbështjellë me pece të ngrohta, që ia ndërronin herë pas here. Pastaj Ylli filloi të ndjente dhembje. Buzët iu gjakosën nga të kafshuarit. Po nuk duronte dot. Në trup, në gjymtyrë, në kokë e në fytyrë i vërshoi nxehtësia. Bashkë me

të ai ndjente se si buçiti gjaku. Lëkura u skuq. Dhe gjaku i plasi nga gishtërinjtë e copëtuar.

— Do t'i bjerë lëkura fare — tha një nga ushtarët.

— Kriston, Petraçin — thërriste Ylli. Ai bërtiste kështu edhe kur të dy shokët ndodheshin aty pranë zjarrit të madh, të zhveshur krejt lakuriq e të mbështjellë me çarçafe që digjnin. Petraçi i kuq, në gjumë, Kristoja i verdhë e krejt pa ndjenja. Krejt i nxirë, si një statujë bronxi e oksiduar. Sa orë kishin kaluar?! Ndoshta kishte ardhur mesdita. Jash-të era vërshëllente. Ushtarët lëviznin në qetësi. Kur dikush bënte shamatë me ndonjë shul arme, e shihnin me inat.

Trupat e dërmuar filluan të lëviznin.

— Bukë — tha Petraçi pas një gjumi të rëndë.

— Tri ditë pa gjë...

U zgjuan dhe dy të tjerët. Filluan t'i ushqenin, se duart e tyre nuk mund t'i ngrinin lart. Atëhere dhe shokët e udhës së gjatë u panë në sy. Buzëqeshën. Dëshën të përqafoheshin, por plagët e lëkurës u digjnin.

— U lodhët, shokë? — pyeti Ylli.

— Jo — thanë ata të dy.

— Keni uri?

— Sidomos Kristaçi — tha Petraçi.

— Për qëndrueshmëri të lartë ju falënderoj!

— tha Ylli me një ton solemn.

— I shërbejmë Republikës Popullore të Shqipërisë! — u përgjegjën ata.

— Shokë, vazhdoni sipas orarit të ditës — urdhëroi Ylli duke u kthyer nga ushtarët.

Nga dhoma tjetër vinte zhurma e njohur e aparaturave të ndërlidhjes, »Teleskopi, unë Trimi...»

«Bota e madhe...», mendoi Ylli.

«HOLTA»

«Holta» nuk është emri i ndonjë vajze. Është emri i një lokali të bukur. I të vetmit lokal me emër. Më i bukuri i qytetit të vogël, që preferohet veçanërisht nga banorët, siç preferohen hotelet e turizmit nëpër qytete.

Sonte këtu në «Holta» ka dasmë. Unë jam i ftuari i çiftit. Kërcejmë dhe këndojmë. Sekretari i partisë i rrethit vallëzon me një punëtore të uzinës, një djalë i ri me të shoqen e sekretarit. Mua më del nga thellësia e kraharorit një psherëtimë e gjatë. Pas kësaj psherëtime unë e di se fshihet një botë e tërë mbresash...

...Atëhere, kur erdha për herë të parë në këtë qytet, shumë gjëra ishin ndryshe. Edhe «Holta» e re ishte hijerëndë. Në të dhe në lulishten e saj, tri-dhjetë-dyzet metra mbi brigjet e zallit të lumit të mbushur me plepa, hynin shkrimtari i qytetit, disa arësimitarë të gjimnazit të ri dhe tre-katër djem. Quhej një luks i veçantë frekuentimi i lokalit, megjithëse, kur qe inaguruar, kishte marrë pjesë gjithë qyteti.

Unë, sigurisht, kur erdha për herë të parë në këtë qytet, këtu e tetë vjet të shkuar, nuk e dija, se «Holta» kishte abazhurë importi në tavanin deko-

rativ, pllaka me mozaik, kamariere që ecnin të lirshme, banak me ekspres. Tamam si çdo lokal i zakonshëm kryeqyteti. Mirëpo, kur hyra atëhere, vështrimet e gjashtë njerëzve u kthyen rrëmbimthi nga unë dhe më përshëndetën me një energji që s'ia vlente. Thua jse kishte ardhur në lokal një fllad në mes të zagushisë e monotonisë që mbretëronte aty e jo një njeri i zakonshëm. Dikush pëshpëriti diçka të pakuptueshme që nuk arriti të kapej nga veshët e mi.

Që nga ai çast. dhe këtë që do të them e kuptova menjëherë, u bëra në qytetin e vogël një njeri me rëndësi. Këtë e kuptova pasi më shikonin të gjithë, bile dhe nga dritaret e shtëpive. «Holta» më pëlqeu. Aty ishte kaq qetë, sa mund të punoje e mendoje pa të ngacmuar njeri. Kamerieret e pastra gëzoheshin kur hynte njeri në lokal e të shërbenin shpejt.

Gjatë atyre ditëve të shërbimit rrija me kënaqësi në atë lokal. Mbrëmjeve në lulishte kishte muzikë të lehtë nga orkestra modeste e tre djemve, që s'ua vinte veshin njeri. Njerëzit, që shtoheshin mbrëmjeve, e kishin mendjen te gotat dhe mezetë me aromë mishi. Ku ajo orkestër e tetë vjetve të shkuar, ku kjo e sotmja!..

Dasma në lokal e në bar-lulishten e tij vlon.

*
* *

Të gjithë këta çifte që kërcejnë sonte se pse u ngjajnë në përfytyrimin tim atyre të dyve. Gratë e vajzat e qeshura, sipas syve të mi, kanë nga një pjesë të qënies së saj, të leshverdhës që kërceu po në lulishten e këtij lokali atë mbrëmje korriku të

tetëvjetve të shkuar me djaloshin e saj. Te çdo njëra prej këtyre vajzave e grave që vallëzojnë unë e shikoj leshverdhën... Ishte një vajzë e qeshur. Kur qeshte me zë të lartë, dhe kështu qeshte shpesh, i valëzonte i gjithë trupi. Edhe flokët që i derdheshin mbi supe. Zëri i saj i hollë dhe melodioz shponte gjithë ambientin përreth dhe njerëzit hiqnin gotat nga buzët dhe linin pirunjtë mbi pjata. Diku ndërpritej një bisedë shokësh. Mua më ngjante ajo e qeshur si fëshfërima e plepave të zallit të madh të lumit, mbi të cilin ngrihej lulishtja. Dhe ndjeja freski të madhe. Mbante vapë të madhe ky qytet, sa edhe gurët plasnin. Mua më dukej atëhere se e qeshura e saj, ashtu si flladi i këtyre plepave, e shponte tejprtej këtë qytet të heshtur e të vakët, që sapo kishte filluar të quhej qytet.

— Po kjo pse hingëllin këshu?! — pyeti dikush.

— Nga mbiu në qytetin tonë?!

— E solli uzina. Uzina e solli...

— Po jo që të hingëllijë, të punojë.

Ajo nuk i dëgjonte ata dhe qeshte. Dhe gazi i saj bashkohej me gurgullimën e ujërave të lumit duke krijuar në veshët e mi një melodi të dyfishtë.

— Pa pikë turpi — tha përsëri zëri i egërsuar.

Po ajo qeshte dhe zëri i saj shponte tej e mbanë bar-lulishten.

— Vend i mrekullueshëm, Gimi, i mrekullueshëm,

— Ç'bushtër! — shau zëri.

— Nuk paska asnjë grua këtu, Gimi, asnjë s'paska — kumboi zëri i saj dhe fytyra e qeshur iu vrejt. — S'ka të fejuar këtu? Po të martuar?

«Holta» ishte e heshtur dhe dukej sikur dremiste. Por në të vërtetë ajo përgjonte leshverdhën.

— Ra përsëri orkestra. Ajo u çua menjëherë.
— Të kërcejmë, Gimi, të kërcejmë. Është një vend romantik.

Dhe ajo priu në pistën e vogël.

I dha belin djalit, ndërsa kokës një lëvizje prapa. Flokët e verdhë shkuan e zunë vend mbi shpatullat e saj. Sy të skuqur e të etur shikonin çiftin që vallëzonte. Që kur ishte ndërtuar «Holta» dhe bar—lulishtja e saj me pistë, ky ishte çifti i parë që kërcente. Kjo ishte një diçka e veçantë për ata njerëz që mërmëritnin rreth gotave. Prandaj edhe personeli i kuzhinës ishte zgjatur në dritaren e servirjes së mezeve. Edhe kamerierët që dremisnin brenda në «Holta» kishin dalë në prak të derës.

«Holta» lëvizte e shqetësuar me zhurmë gërvishëse karrigesh. Rrëke të turbullta, sikur e ushqenin edhe më tepër zemërimin e saj. Ajo fryhej e fryhej.

— Do na prishë gratë dhe vajzat tona të urta — u ankua dikush.

Një tjetër u ngrit me zhurmë nga karrigja dhe, pasi hodhi mbi pjatën e bukës një dorë me monedha, u largua duke u lëkundur e duke thirrur.

— U shtur qyteti, iku qyteti, erdhi farë e keqe...

Personi që rrinte në një tryezë me mua sa nuk e përpinte me sy atë, pa e hequr llullën nga goja. U kthye menjëherë nga unë e më tha:

— Megjithatë është artificiale.

— Pse?!

— Nuk shkon.

— Pse nuk shkon?

— Nuk është vendi. Qytet i humbur.

Unë nuk e kuptoja atë. Por edhe ai nuk e kuptonte pse ishte artificiale. Një i dytë u ngrit me zhurmë nga karrigja, duke sharë me gjuhën e trashur dhe u sul me biçak mbi baterinë dhe trumbetat. Melodia u mek dhe çifti mbeti në mes të pistës. «Holta» mërmëriti në mënyrë të pakuptueshme. Vajza e pa me inat burrrin e parruar me sy të egërsuar. Kurse ai gajasej i lumtur, duke tundur në dorë një copë lëkurë.

— Ha, ha!.. Kultura... ku vajti... hi, hi!..

Ajo e shikonte dhe dridhej. E tërhoqi për te tryeza shokun e saj që desh të përplasej me atë që i preu buzëqeshjen shoqes së tij. Mori trikon dhe e hodhi kraheve. Dridhej.

Dikush vërshëlleu nga gjysmerrësira e bar-lulishtes.

— Mos na ndyj lokalin, qytetin, zakonet, jo...
— bërtiti i dehuri.

Ajo hodhi sytë e zemëruar nëpër lulishten dhe përsëri u drodh megjithëse pa edhe vështrime të çiltëra. Edhe shokun tim të tryezës, edhe mua na pa. Po ai uli kokën.

Dy veta u ngritën në këmbë dhe i vajtën pranë të dehurit. Në fëtyrat e tyre kishte shqetësim dhe revoltë. Dy kamarieret e lokalit dhe guzhinieri nxituan po aty.

— Ikim — buçiti zëri i saj. — Kam ftohtë.

Ajo u nis përpara dhe shoku i saj, që desh të bashkohej me ata të pestë që ishin ngritur në këmbë, u detyrua ta ndiqte duke lënë pagesën mbi tryezën e metaltë.

Ajo u kthye nga ai dhe i tha:

— Vështirë do ta kemi këtu, Gimi.

Dhe buzëqeshi hidhur. Pastaj pa nga gjysmerrë-sira ku vazhdonin të qeshnin. Gimi mohoi me kokë.

«E trembën, e trembën», mendova unë, duke hedhur një kupë më shumë. Pashë nga ai që më bente shoqëri. Rrinte kokulur.

— Thashë, — tha — artific, godet kundër ambientit.

— Pse, ç'duhet të bënin, të mos kërcenin?

Ai ngriti supet.

— Ajo të pa ty — i thashë.

Ai u skuq dhe s'foli. «E trembën, e trembën», mendova unë përsëri duke e harruar fare bashkëbiseduesin. Nga ana e orkestrës vazhdonte poterja. U ngrita dhe unë për të vajtur atje. «Ajo do të vijë përsëri këtu», mendova dhe sepse e ndjeva veten të lehtësuar.

...Kanë kaluar tetë vjet që atëhere kur kërceu leshverdha në pistën e bar-lulishtes. Kurse tani... tani në «Holta» bëhen dasma socialiste. Pista sonte është plot e përplot. Edhe mozaiku brenda lokalit është nën pushtetin e dasmorëve.

Ku është tani bjondja që e fyen atë natë, zogu që e trembën atë natë?.. Të jetë tani në këtë dasmë me siguri do të provonte ndonjë nga ato kënaqësitë që i dëshirojmë shumë. Dhe sytë, sytë e bukur do t'i mbusheshin me lot. Po kush tha se ajo nuk e ka ndjerë këtë kënaqësi një vit më parë, një javë më parë e ndoshta edhe sonte diku tjetër?

Shumë gjëra kanë ndryshuar tani në këtë qytet. Vajzat mund të bisedojnë me ty krejt lirisht në breg të lumit, duke djegur në rërë trupin e zhveshur. Ato ëndërrojnë që te plepat e zallit të hapet një liqen i vogël me shelgje lotuese anash, ku të

ndërtohet një bar-lulishte me orkestër e me pistë vallëzimi. Dhe unë mendoj se ndonjë prej këtyre vajzave mund të bëhet autorja e projektit të bukur të këtij ëndërrimi... Vërtet shumë gjëra kanë ndryshuar në këtë qytet. Me përjashtim të atij, shokut të tryezës. Jo se ai mban përsëri borsalino të zezë, jo se vazhdon të lexojë libra në gjuhë të huaj. Jo.

... Ai erdhi në tryezën ku rrija unë që ditën e dytë të shërbimit në këtë qytet të vogël, po që, atëherë, ishte edhe më i vogël. Erdhi si një i njohur dhe më gostiti me arançatë.

— Jetë e mërzitshme — më tha. — Apo jo?

Dhe i bindur se unë, si njeri i ardhur nga një qytet i madh, do ta aprovoja mendimin e tij, pasi po më qante hallin dhe ishte nga të vetmit që më kuptonte, rrudhi fytyrën e paktë të zverdhur, bile edhe lëkurën e kokës tullace, siç dukej për t'iu përgjegjur gjendjes sime shpirtërore.

— Pse? — e pyeta unë.

— Si pse?! — u çudit ai sa s'kishte më. — Sepse është e mërzitshme jeta në këtë qytetin tonë, ku njerëzit akoma të shohin fshehur prapa perdeve. Në dimër shumë ftohtë, në verë shumë vapë.

— Kështu është kudo dimri dhe vera.

— Njësoj janë, vërtet, por këtu, po të veshësh një «gubën», të qeshin, po të shkosh të lahesh në lumë si ata të dy të marrët, inxhinieri me mësuesen, prapë të qeshin.

— Megjithatë në lumë ka çdo ditë njerëz.

Ai më shikoi i çuditur, bile si i zhgënjyer për vlerat e mia si intelektual i një qyteti të madh e të dëgjuar. Më shikoi sikur shikonte ndonjë të zgjuar që sapo kishte lajthitur nga mendtë.

— Artific, artific. S'ka alegri. Femrat janë gati të mbulojnë këmbët edhe aty në rërë. S'bie erë plazh, bie erë fshat. Qytetërim me zor. Durrësi, po, femra të çiltëra, që luajnë me djemtë, ngjyra të ndezura, dancing, të huaj... Jetë, jetë...

Ai u drithërua.

— Po ju keni qënë në lumë? — e pyeta.

Tundi kokën në shenjë mohimi dhe buzëqeshi në atë mënyrë si të mos thoshte: «Pse, mund të merrem unë me gjëra të tilla?!» Nuk kanë njohur akoma një tjetër njeri që të flasë me buzëqeshje siç flet ai.

...«Holta» gumëzhin nga zërat gazmorë. Dikush uron çiftin me zë të lartë duke e kthyer me fund. Të ishte ai këtu, ç'do të thoshte për këtë të qeshur zhurmëmadhe e për këto të thirrura pa kufi? Asgjë s'mund të them. Po e ndjej se do të buzëqeshte dhe do t'i pëshpëriste vetes ndonjë gjë pa kuptim, i trembur, shumë i trembur...

— U plak «Holta» — më tha sot në mëngjes.

— Pse? — e pyeta.

— Si pse? Nuk shikon si hyjnë njerëzit me qilota shajaku? Nga mali drejt e këtu, sikur hyjnë, më fal, në qilaz. Shih si ta pinë me shishe arançatën duke qeshur si budallenj.

Më shikoi si për të kuptuar në se ma kishte mbushur mendjen,

— Tani dhe pikërisht tani ky lokal është rinuar, ka marrë jetë — thashë.

— Tani, si tani? Tani që s'gjen karrige ku të ulësh! S'gjen më një lokal ku të rrish i qetë, të mendosh, të krijosh...

«Ç'krijon vallë ky?» pyeta unë.

— Sa të mbarojë «turizmi» — shtoi. — Po edhe

aty do të dyndin këta, pa të keq. Ec e ndaloi, po të duash.

— Do të venë edhe aty, se i tyre do të jetë edhe turizmi — thashë unë.

Ai hoqi syzet dhe m'i nguli zgavrat e syve për një kohë të gjatë...

— Të gjithë të hyjnë, të gjithë?

— Të gjithë.

Ai më tregoi dritaren.

— I njeh dot ato çupat me opinga e brekushe që zbritën nga fshati këtu e dhjetë vjet të shkuar për të mësuar maqinat e uzinës? Jo, s'i njeh! Nuk njeh as ato që erdhën vjet. Shihi se si të tunden me fustane. U qytetëruan.

— Pikërisht këtë sjell klasa punëtore dhe ne këtë duam.

— Po është një qytetërim fals. Qytetërimi do vite ,do kulturë.

— Po mirë, te ne të dy ku qëndron kultura? — e pyeta.

— Hëm, si të them, është vështirë të flasë njeriu për veten. Po, ja, ndjenjat...

Ai heshti. Edhe unë heshta. Ai ktheu përsëri kokën e pa jashtë dritares, ku shëtisnin vajza të qeshura e të bukura. Përtej tyllit të larë ato dukeshin sikur kishin hedhur vello. Një grumbull njerëzish shumë i madh shoqëronte një çift që martohej. Ishte ky çifti që kërceu sonte këtu.

— Martohen — tha ai.

— Jeta e tillë është — thashë unë po aq thatë.

— Nuk e vë re një gjë interesante? Ata po ecin në këmbë.

— Pastaj?

— Sikur s'ka lezet fare. Diçka bajate, pa emoci-
cione.

— Mua më duket sikur ka lezet shumë dhe me shumë emoci-
cione.

Çifti qeshi i gëzuar, përshëndeste me kokë majtas e djathtas. Nusja u përkul e puthi një fëmijë që i doli përpara.

— S'ka fare lezet — këmbënguli bashkëbiseduesi, sikur të mos i kishte dëgjuar fjalët e mia.

— Thjeshtësi — thashë unë.

— Djali është mekanik, vajza oficere. Të kishte marrë edhe çizmet ajo — desh të qeshte ai, ndonëse fytyra i kishte marrë një pamje të përvajshme.

— I njoh, i kam shokë — ia prita unë. — Dhe shtëpitë i kanë ngjitur.

— Ashtu! Domethënë sonte je këtu në «Holta»?

— Po.

— Dhe ne do të na nxirrni jashtë për të bërë dasmën?

— Po.

— Po ne ku do të shkojmë? Këto dasmat po shtohen. Shko njëherë miu mbi mjekër dhe e bëri udhë.

— Në shtëpi.

Ai thithi duhan dhe tundi pëllëmbën e vockël para fytyrës së vretur e të menduar, sikur me këtë desh të thosh: «Lere».

...«Holta është në kulmin e haresë. Mua më duket sikur sonte ajo ka zbritur vërtet me bujë nga grykat e saj të bukura e të gjelbëra dhe është derdhur këtu me të gjitha ngjyrat e saj të pranverës.

Po afron dita e re dhe dasma vazhdon...

HIJET

Ai e përqafoi flokëgjatën. Plaku u shty më prapa. «Pizevengu!, mërmëriti ai. Prandaj e paska sjellë gjer këtu pilivrickën ky vagabond», shtoi pas palk, kur çifti nuk po shqitej. Ishte vërtet i zemëruar atë mbrëmje pranvere roja e ndërmarrjes. Bënte ecejak rrezë mureve dhe shante nëpër dhëmbë prindërit e dy të rinjve që putheshin nën kumbull.

Rrezja gjigande e dritës që ngrihej nga qyteti drejt qiellit ua ndizte fytyrat edhe dy të rinjve, kaçurrelit dhe flokëgjatës. Kështu e quajti plaku menjëherë, sapo ata shkuan nën kumbullën e motshme dhe u ekspozuan si pa të keq para syve të plakut në relievin e dritave të panummërta të qytetit, që shtrihej aty poshtë, në këmbët e kodrës.

Në fillim, kur që larg u dukën hijet e tyre, që po afroheshin, plaku u vu në përgjim. Kushedi, ndonjë budalla që kujtonte se do ta gjente në befasi e do mundahej të hynte në ndërmarrje. Po e kuptoi se ata të dy nuk ishin të asaj pune. Ata të dy e kishin mendjen të mbështeteshin sa e sa më shumë të njëri-tjetri. Ishin ulur inbi bar dhe vështronin detin e dritave të qytetit. Rrinin aty dhe çuqurisnin të gëzuar. Ai i lëmonte flokët dhe e përqafonte.

Këto çifte që veçoheshin nga sytë e botës plaku nuk i donte. «Si ua lëshojnë kaq kapistrën xhanëm!» bënte çudi ai duke përshtyrë përtokë. Ec e pështy. Sytë nuk desh t'i hidhte nga kumbulla, po ata shkonin vetë aty, pa iu bindur atij. «Më ndynë kumbullën», mendoi plaku me maraz dhe me xheloz. Çdo ditë, për vite me radhë, nën degët e kumbullës ai kishte dredhur cigaret duke ndjerë se si rritej e zbukurohej qyteti i tyre. Tani që kishte dalë në pension, por kishte mbetur si rojë aty, çdo natë, nga ajo kumbull i gëzohej qytetit të mbytur në dritë neoni.

I shkoi mendja te djali i madh. I kishin pëshpërritur se ai e kishte trashur si shumë me një nga ato të uzinës. «Dhe e di, i kishin thënë më pas, është nga ato që dalin e kërcejnë në sheshin e qytetit për çdo festë për të bërë gallatë miletit». Plakut, sikur i kishin mbetur buzët e pjekura në filxhanin e kafesë. Kishte dalë menjëherë jashtë nga kafeneja. «Do t'ia bëj pestil kokën atij qeni. Pa pyetur babanë. Harbon sokakëve e më fshihet me marifet».

Ai desh ta shkundte mirë për jake të birin, por djali tani ishte rritur: ishte me shkollë. Ai duhej të dinte se ç'bënte. «Epo djalë është, kishte thënë me vete, të ishte çupë, e...» Në kafene, të tilla fjalë thuheshin përditë. Veç atij ia kishin thënë në sy. Ç'do të ishte ajo çupë që i vardisej të birit? Po ai mos ishte njeri pa njeri. T'u thoshte atyre, të lidhnin krushqinë, po të ishte e thënë dhe pastaj le të bridhnin pa iu fshehur njerëzve, si bëjnë këta këtu. Ama jo të bëjë sipas kokës së tij. Jo si këta që vijnë gjër këtu. se e kanë me hile.

Çifti iku shpejt dhe ai nuk ua pa dot fytyrat. Kishte shumë dëshirë t'ua shihte fytyrat. «Kushe-

di si e kanë hallin, xhanëm! Do të jenë shkollarë që duhen. Po mirë se duhen, pak udhë e ulica ka qyteti ynë?, mendoi ai. Me ikjen e tyre plakut i kishte dalë inati. Mendoi një herë se mos ai ishte i biri. Buzëqeshi. «Atë e njoh me erë unë». Eci deri te kumbulla, lulet e së cilës ndrisnin nga rrezet e zbeta që sillte deri aty prozhektori i madh i llambave të qytetit.

— Nuk dihen hallet e njerëzve, jo — tha me zë.
— Nuk duan t'i bashkojnë të tjerët, kushedi.

Plakut i thoshte mendja se ata të dy do të vinin prapë. Dhe vërtet erdhën. Më parë u duk hija më e gjatë, ai, dhe më pas ajo. Të dy hijet u ulën nën kurorën e bardhë e të gjelbër të kumbullës së motshme. Plakut përsëri i hipi gjaku në kokë dhe u ngjesh pas murit.

Çifti filloi të vinte shpesh te kumbulla. Në të njëjtën orë, pa zhurmë. «Gjetën karër këtu. U pëlqen vendi», mendoi rojtari. Plaku ishte mësuar tani me ata të dy dhe, ndonëse s'ua kishte parë akoma fytyrat, i dukej sikur i njihje prej kohësh dhe mendohej të futej në shpirtin e tyre. Jo vetëm që nuk shante më si më parë, por, kur kujtonte se ata të rinj s'bënin mirë që vinin aq larg qytetit, mendohej t'i lehtësonte.

Kishte qenë dikur edhe ai i ri. I ishte dredhur zemra si purtekë, ishte djegur edhe ai përbrenda nga malli. Kjo ia zbuste zemrën dhe s'i bënin këmbët t'u prishte rehatinë atyre të dyve.

Ai kishte qenë berber ambulant. Shëtiste fshatrave me dy brisqe e një pasqyrë të thyer në torbë. E kush nuk e njihje Sulo berberin, që bridhte tërë kasabanë dhe hakun e merrte bereqet në fund të vitit? Apo nuk kishte edhe zanat. Mirëpo, një

ditë edhe atë e fejuan. Po të fëjuarën nuk e njihete. I ngrohej zemra se i thoshin që kishte rastisur çupë e bukur. Gjaku i ziente Sulo berberit. Desh ta njihete. Mirëpo kjo ishte më e rëndë se një turp. Ishte edhe prishje bese, edhe zakoni. E megjithatë atij iu nxeh koka. Vendosi ta shkelte ligjin. Torbën në krahë dhe hë, në fshatin e saj. Ishte kohë të korrash. Qethi nja dy të rinj që i kishte shokë tek shihnin në lëmej e mësoi se ajo, e fejuara, nuk e kalonte prakun e shtëpisë, qëkurse ishte fejuar. Ishte vetëm në shtëpi, se të tërë kishin dalë në fushë. Ai u nis drejt e në shtëpi, Trokiti fort. Diçka u përplas në pllloçat e oborrit. Hapa që u larguan. Trokiti përsëri. E shtyu portën dhe hyri në oborr. U mërzit. Qejfi ia kishte që portën t'ia hapte ajo dhe pastaj ta ftonte brënda me buzë në gaz e sigurisht, me kokën pak të ulur.

Një kovë ishte përmbysur pranë pusit. Dyert ishin të hapura. Në hajat disa petë ishin shtruar në një tepsi të madhe, kurse të tjera ishin hapur mbi një çarçaf të bardhë të arnuar. Një pulë po i çukiste ato me nge, duke kakarisur e kënaqur. Okllaia ishte hedhur në dyshemenë prej balte. Ai zgjati kokën brenda një dere. Dritarja që binte nga oborri ishte e hapur dhe lëvizte. Ai shtrembëroi buzët. Dukej sheshit që dikush kishte ikur me të shpejtë. Doli në oborr dhe mori për nga porta. «Paskan vënë raki, mendoj kur pa një fuçi të madhe pranë pusit me çikrik. Për dasmën tonë». Zgjati kokën. Dhe ç'të shihte! Aty brenda nuk kishte kumbulla. E mbledhur sa një grusht, aty brenda ishte ajo, nusja e tij e ardhshme, teto Nimetja e sotme. Dridhej e shkreta çupë dhe kokën nuk e ngrinte...

I kujtonte këto xha Suloja dhe psherëtinte:
«Kot i shava në fillim. Le të njihen. Edhe im bir le të njihet. Se s'do të njihen si qëmçti nëpër qypa. de».

Shpeshherë i vinte të shkonte aty nën kumbull e t'u thoshte dy fjalë të mira, t'u thoshte që ta donin shumë njëri-tjetrin, t'u thoshte se edhe ai kishte qenë i ri, t'u thoshte se edhe djali i tij çoç kishte një zogëzë. Po këtë s'e bëri asnjëherë.

Ndodhte që binte shi dhe ata nuk vinin për net të tëra. Plaku shqetësohej. E hante pa kuptuar mera-ku se vallë a do të vinin më. Shkonte te kubulla dhe sodiste qytetin e larë në drita. Kushedi se si e shihnin ata qytetin! Ndoshta atyre u dukej më i bukur qyteti, si në përrallë. I bënte dashuria ta shihnin ashtu. Mundohej edhe ai ta shihte si ata qytetin. Po nuk mundej. Megjithatë nuk i vinte inat. Ai e kish-te parë atë qytet edhe të varfër, edhe të pisët, edhe të uritur, edhe të djegur, edhe pa një kandil dritë. As jetën nuk mund ta shikonte si ata të dy, sepse ai kishte të shkuar e ata jo. Ata kishin të ardhme.

Shkoi behari dhe filluan shirat e vjeshtës. Dëgët e kumbullës u zhveshën e u mavijosën. Vetëm aty poshtë dritat e neonit ndriçonin si gjithnjë. Rrugët e lagura shkëlqenin si pasqyra gjigante, ndërsa era filloi të vërshtëllente netve të ftohta. Çifti ngjitej rrallë në kodër dhe më pas nuk u duk më.

«Tamam si dallëndyshet, mendonte plaku në kabinën e tij të ngrohtë. Do vijë pranvera dhe ata do të vijnë përsëri. Do vijnë, do vijnë». Dimri ishte i ashpër, netët e gjata. Por plaku nuk e harroi çiftin e ri. Nuk e linte kumbulla t'i harronte. Ai priste

pranverën. Dhe ajo erdhi. Bisqet e kumbullës shpërthyen të shëndetshme, pastaj shpërthyen edhe sythet e krahët e saj veshën kostumin e gjelbër. Më pas ajo u mbush me lule të bardha. Ajo u zbukurua shumë atë pranverë. Dukej sikur priste dy të rinjtë. Plaku nuk shkeli te kumbulla. «Ata e duan shumë njëri-tjetrin dhe do të vijnë. Edhe të martuar qofshin, duhet të vijnë». Ndjente mall plaku për dy të rinjtë. «Edhe ajo e tim biri na paska thënë se na dashka shumë. Teto Nimetes i thotë kështu i biri. Nga xha Suloja ka turp qafiri. Po edhe faj s'ka, se i kam ndenjor me hundë. I duhet rregulluar dhoma, se atij s'i bie ndër mend. Pa duhen vënë ca lule në oborr. Mjaft me atë misër që mbjell unë, sikur jemi pa bukë».

Mendonte plaku e ndjente mall për të ritë e tij, që i kishte kaluar ashtu me mundime, duke bredhur fshat më fshat me torbë në krahë, mal më mal me pushkë në dorë. Për bukë e për liri. . .

Shikonte kumbullën që i dukej si e shkretë dhe i priste ata. E një mbrëmje të vonë, kur hëna preratitej të kapërcente këtej malit, pranë kumbullës u afruan dy hije. Ato u shkëputën pak nga njëra — tjetra, pa i zgjidhur duart dhe prapë u bashkuan. Në këtë ndarje, duke pasur si relief qytetin me detin e dritave, plaku njohu kaçurrelat e djalit.

Çifti u ul si dikur me vështrim nga qyteti. Diçka filluan të përshpëritnin. Plaku u soll rreth godinave dhe zuri vend pranë kabinës së tij. Ndërkaq hëna u çapit mbi kurriz të malit dhe ndriçoi gjithshka. Të rinjtë u kthyen nga ajo për të shijuar bukurinë.

. . . Si e priti atë mëngjez roja e ndërmarrjes! Sa e gjatë iu duk nata! Sa hërë e pa ai sahatin e bukur të xhepit!

Kur qyteti u gjallërua, gjithnjë me tëmtha që i rrihnin fort e me trupin në ethe, ai gati vraponte tatëpjetë. Nuk vinte re as rrugët e pastruara e të spërkatura nga vesa e mëngjezit dhe maqina e komunales, as njerëzit që nxitonin për në punë me sy nga ora e madhe e qytetit, as të njohurit që i uronin mëngjez të mirë. Nuk u ndal plaku atë mëngjez të pinte kafënë «turke» e të këmbente me nge ndonjë cigare me moshatarët e tij, që ktheheshin në shtëpi me shishet e qumështit në duar.

Ai hapi me rrëmbim derën e oborrit e nuk u ndal të vadiste si zakonisht lulet, duke thirrur teto Nimeten.

Ballë për ballë pa të birin që fshinte shkumën e sapunit. Në krah të tij e shoqja dhe një vajzë. Plaku mbeti te dera.

— Hm, e përplasa shumë... Mirëmëngjez!

Ata të tre u përgjegjën, por ai dëgjoi vetëm zërin e hollë e të dredhur të vajzës: «Mirë mëngjez!...». Po, menjëherë, harroi në i tha «xha Sulo» apo «baba».

— Hm, — tha përsëri plaku — erdha shpejt sot.

Dhe pa mundur të thoshte gjë tjetër, pa nga e shoqja. Vajza e skuqur deri në vesh shikonte nga plaka, kurse i biri, që gjysmën e fytyrës e kishte lënë me shkumë, mundohej të mbërthente këmishën pa mundur të urdhëronte dot gishta të qe i dridheshin.

— Ja, Sulo, — tha më në fund plaka — kjo është nusja jonë. Shkojnë çdo mëngjez bashkë në punë.

— Hm — bëri plaku për së treti, sa djali buqëqeshi. — Dhe fshihen nga unë, ë.

Ai, tërë gaz, iu afrua vajzës, e kapi për supesh dhe e puthi në ballë.

— Tjetër herë të më prisni edhe mua kur të vij nga puna, morët vesh. Do të vij shpejt, si sot.

Zëri i tij kumboi në kuzhinën e ngrohtë.

— Dhe ti t'u thuash që sot babait, nënës sate, dëgjon?

Vajza buzëqeshi.

Pastaj ai doli jashtë, jo se deshte, por se e mbytën ca lot të nxehtë që po u afroreshin syve të tij të plakur...

NESIMI

Në mes të fshatit tonë është një lapidar. Pranë tij shkojnë shokët në mëngjez për në punë dhe e pyesnin:

«Si u gdhive, Nesim? Po ngrin?»

Ai buzëqesh.

«Ç'është kjo e ngrirë! Si më keni veshur ju... Atëhere kisha vetëm lecka, sa s'kishte ku të më zinte qeni, po...»

«Kemi mbledhjen e këshillit popullor sot, mos harro...»

«Jo, jo. Aty më kini...»

Shkojnë fëmijët e shkollës dhe e pyesin:

«Xha Nesim, mirë mëngjez! Sot kemi hartim për elektrifikimin e plotë, si ta fillojmë?»

Ai zgjat dorën e thatë dhe u përkëdhel flokët.

«Shkruani se dritën e solli partia, e solli zjarri i pushkës partizane...»

*

* * *

Nesimi qëndronte i papërkulur mbi këmbët e veta të gjata, të hapura anësh. Vështronte me inat. Duart i ishin varur poshtë: grushtet i mbante të shtrënguara.

— Ngordhi koha juaj! Ne e kemi ngritur këtu qeverinë tonë, këshillin nacionaqlirimtar. More vesh, more kryeplak?

— Ju kanë marrë mendjen ca çunakë, qëkur djemtë heqin për hunde baballarët në Shqipëri! Ku i keni zakonet e të parëve, bre? — tha kryeplaku. — Balli kombëtar është për Shqipërinë, jo komunistët!

— Po kur do ta marrësh vesh, zotrote, se ne nuk kemi dy palë faqe, por një e të bardhë — ia ktheu Nesimi, duke thërmuar më gishtat e zeshkët pak miell, që sapo doli nga çuri i mullirit.

— Ne duhet të shkruhemi me Ballin dhe t'u themi: tutje nga fshati i partizanëve — tha një fshatar trupvogël, duke ngritur në kurriz një thes për ta çuar te qerrja e kryeplakut.

— Ty të njohim që i lëpin opingat këtij — i tha Nesimi. — Po mblidhe mendjen, se s'është shumë vonë.

— Sikur të iku pasuria ty, që pëllet kështu!

— Ashtu...

Kryeplaku dhe fshatari i hollë ngarkuan dhe u nisën përpjetë.

Fshatarët kishin dalë te dera e mullirit dhe qeshnin.

Kryeplaku i dëgjoi të qeshurat deri larg.

«Do t'jua rrëfej qejfin, qelbanikë, që ma quani veten qeveri! Ku e gjetët tërë atë miell, sikur s'e di unë që s'kini ç'të hani as për mëngjez...»

— Shpejt bre burra! — tha Nesimi kur hynë brenda.

— Çeta ka dy ditë pa bukë!..

Nesimi i ngjitej kodrës me maliherrin në dorë dhe me një thes në kurriz. Prapa vinte Ramadani, i biri, me një pushkë të gjatë, më të gjatë se vetja. I kish-te a jo të gjashtëmbëdhjetat. Nga gjatësia i kishte ngjarë të atit. Edhe ai mbante në shpinë një thes plotë me bukë misri.

— Nxito, bir! — përsëriste Nesimi, duke ndje-rë mbi shpatullat ngrohtësinë e bukës e duke përcjellë pështymën. S'kishte futur asgjë në gojë, ndo-nëse bashkë me të shoqen kishin pjekur tërë natën. Kur pesë vocërakët e tij kishin dalë për ta përcjellë te dera e kasolles gjysëm të rënë, kishte nxjerrë një bukë nga thesi e ia kishte dhënë gruas:

— Kujdes fëmijët, grua... — Po s'kishte vazh-duar dot më gjatë. Kishte rregulluar edhe një herë gjerdanin e vjetër plot me fishekë dhe kishte ngritur thesin në kurriz. «Një bukë më pak...» kish-të përshpëritur i dëshpëruar...

Tanimë fshati kishte mbetur prapa, në gjysm-errësirën e agimit. Ata, tërë djersë, duke marrë fry-më thellë, ngjiteshin përpjetë. Po kishin ende shumë rrugë për të bërë deri te partizanët.

Zëra të mbytur u ndjenë përpara dhe Nesimi qëndroi. I bëri me shenjë të birit që të ndalonte.

— Ndal!

Ata u shtrinë barkas dhe përgjuan.

— Janë ballistë. I paskan zënë të tëra shtigjet!

— Ah, kryeplak, spiun i fëlliqur! — tha Ne-simi. — Nisu për në fshat, bir, e lajmëro! Po e pe që të zunë, shtjerë tri herë dhe ata do ta marrin vesh.

Po djali nuk luajti nga vendi.

— Baba...

— Nisu, malukat! S'më ha mortja mua, mos ki frikë.

Burrit i erdhi keq për të birin. E kishte më të madhin dhe kudo që shkonte e merrte me vete. Priste t'i bëhej krah.

Nesimi dëgjoi një batare pushkësh.

— Ah! — thirri dhe vështroi me kujdes mos shihte gjë nëpër mjegull. Pas asaj batareje ranë të tjera, të cilave, iu përgjegjën krisma të veçanta, të dobëta.

«Po qëllon im bir. Të lumtë, djalë, të lumtë, trim!» — mendoi i gëzuar Nesimi dhe u zvarrit për tek i biri. E gjeti dhe e pyeti me zë të dridhur, duke i kapur shpatullat.

— Ke plagë, biro?

— Jo, jo, baba, jam mirë — tha djali.

— E, më të lumtë! Tani ikë, djalo, po ki kujdes se po qëlloj unë këtu — tha babai dhe shkrehu kot përpara.

Djali u nis dhe babait iu përgjegj një batare e gjatë. U mbështet mirë pas një guri. Mjegulla po largohej. Por prapë nuk mund të shikoje qartë përreth.

— Ne e dimë se je ti, Nesim Eshkaxhiu, me shokët e tu. Ju kemi rrethuar. Dorëzohuni!

Nesimi qëlloi nga i erdhi zëri, duke bërtitur:

— Prite, tradhëtar i qelbur...

Mjegulla po hollohej. Mori përsëri përpjetë. Sa kishte bërë dy hapa, dalloi silueta që lëviznin drejt tij. Preu djathtas dhe u hodh në përrua. Që aty siluetat dalloheshin mirë. Ato po afroheshin.

«E paskam pisk sot. Bujrum, bujrum. Po s'do të më lënë vetëm shokët...»

Me t'u shtrirë mbi ledh, i fluturoi breshëria e parë mbi kokë. Të parin qëlloi një goxha burrë i cili, për çudi të tij, ishte ngritur në këmbë e bër-tiste si ta kishte zënë njeri për fyti: — Dorëzohu, dorëzohu, dorëzohu!

—Na, o i çmendur!

Ballisti ra.

Pushkë e automatikë kryqëzonin zjarrin mbi kokën e tij.

— Dorëzohu, Nesim Eshkaxhiu, se nuk shpëton dot! Mos merr në qafë veten. Ke një tufë fëmijë. Kush do të t'i ushqejë?

— Do të t'i vrasim edhe fëmijët, po nuk u dorëzove — tha një tjetër.

Nesimit iu kujtuan ata pesë vocërrakët dhe Ramadani me pushkën e gjatë.« E bëjnë këta, s'ia përtojnë...»

Atij i erdhën shumë mendime para tytave të armëve. Nesimi nuk e kishte mbiemrin e vërtetë Eshkaxhiu. Atë ia kishin ngjitur fshatarët. Mblidhte eshkë dhe e shiste në qytet, për të mbajtur me një krodhë bukë veten, gruan dhe fëmijët. Por asnjëherë nuk ishte nënshtruar. E kishin vënë në dru kushedi sa herë, se u kundërshtonte beut, qehallarëve ose ndonjë dhjetari. Prandaj i priti me gëzim çetat partizane. I kujtohej mirë prilli i vitit 1942, kur i kishte folur otëhere ai partizani, që i kishte vajtur në shtëpi natën vonë. Ai ishte Fuat Babani, biri i Devollit. Nesimi e kishte dëgjuar atëhere me gojë.

«Lirinë do ta fitojmë me këtë», i kishte thënë partizani, duke i treguar patickën e tij. Po, tanimë

Fuati nuk jetonte. Ai kishte rënë. Nesimit iu drodh buza.

Armiqtë po e ngushtonin rrethimin. Ata dig lllomotisnin.

— Ta zëmë të gjallë — thirri dikush. — I janë mbaruar fishekët, se s'po qëllon. Dorëzohu!

— Kështu dorëzohen shqiptarët, mor kërma! — thirrri ai dhe u ngrit më këmbë duke hedhur, me sa fuqi kishte, një nga dy bombat. — Merreni!..

Armiqtë u mbrapsën të tmerruar. Nesimi u shtri dhe mbushi maliherrin. Batare plumbash çanë dheun rreth tij. Ai u tulat pas skarpatit. Në anën tjetër dëgjoi batare pushkësh. Fytyra e dërsirë i shkëlqeu. «Martina e Lamkës kjo që kër-citi...»

— Afrohuni të më zini të gjallë, afrohuni! — thirri me zë të lartë.

I zbrazti të pesë fishekët që kishte në krehër. Po një plumb e mori në krah. Një breshëri i qethi kokën.

Nga ana tjetër krismat po dendësoheshin. «I ka lajmëruar trimi i babait», mendoi.

— Dorëzohu, ndryshe në vend të bukëve, partizanët do të hanë kockat e tua... Dorëzohu!..

Ai e pa mirë kush foli. Ishte një oficer. E qëllloi. Oficeri ra duke u ngërdheshur. Armiqtë ishin afruar nja njëzet hapa. Ishin shumë. Një plumb, që i shpoi tejprtej shpatullën e majtë, ia mori krejt fuqinë. Ai mbështeti faqen në pushkë dhe qëlloi.

— Hë de, thuaj viva! Erdhe t'i lije kockat këtu në fshatin tim. Unë, në vdeksha, vdes në baltën time...

Pas kësaj asnjë s'guxoi të ngrihej më këmbë.

— Bjerini, është komunist! — thërriste di-

kush... Po pastaj sikur fjala i mbeti në grykë. Do ta kishte marrë ndonjë plumb i fshatarëve, që qëllonin nga ana tjetër.

Trupi i therte. Kishte kaluar një orë. Plagët i qenë ftohur. «Edhe tre fishekë, tre fishekë dhe një bombë». I përkëdheli në pëllëmbë.

Ai mblodhi edhe një herë fuqitë dhe tërhoqi me dhëmbë mashëzën e bombës. Ktheu kokën nga fshati. Ngado pushkët ushtonin. Populli i tërë ishte çuar më këmbë dhe luftonte.

Nesimi e ndjeu se nuk ishte vetëm.

Armiqtë rrinin shtrirë pak hapa larg tij, gati për t'iu hedhur. Nuk ishin sa në fillim. Një pjesë luftonte buzë lumit me fshatarët, që kishin zënë pozicione dhe qëllonin pa pushim.

E hodhi bombën. Ajo bombë u shoqërua me krisma pushkësh që ndiheshin prapa tij. Qeshi i gëzuar. «Erdhën!.. Ja, tani do të thërrasin: Para, partizanë!» Iu morën mendtë. Ai u hutua. Nuk dëgjoi plasjen e bombës së tij, as lebetitjet. Ai e kishte mendjen te shokët. Ata kishin ardhur. Dëgjoi «Urra» -të e sulmit.

— Ju kam sjellë një bukë më pak... — desh t'iu thoshte partizanëve, por s'kishte më zë.

Pastaj ra. Bashkë me të ra edhe një bombë...

*
*
*

Mbi atë gropë që hapi ajo bombë u ngrit më vonë një lapidar. Ai lapidar duket sikur përshëndet fshatin e ri dhe shtëpinë e re që ngriti partia për ish gjashtë jetimët.

PLAGË TË SË KALUARËS

Nga zyra e kryetarit doli gjithë vrull një vajzë e gjatë, flokëverdhë, me fytyrë ngjyrë gruri të pjekur. Ndërkohë doli edhe kryetari e, sa më pa, më toku dorën.

— Ç'na u bëre, mor shoku agronom? Të presim. Na i latë neve këto zyrat, më ju lumtë! — tha ai.

— Pastaj pa vajzën që priste pranë dritares dhe e thirri pa e lëshuar dorën time.

— Shoqja Teftë, ky shoku është agronomi nga Tirana. Do të shkosh sot ti? Për gjysmë ore? Sa mirë! E kisha në merak të madh se vallë vjen xha Shaqoja.

— Vjen, vjen, si s'vjen — tha vajza.

— Jo, po thashë se mos i merr ti gazetat — tha dhe u kthye nga unë. — Epo, shoku Llukë, siç kemi biseduar, ë? Hajde tani, rrugë të mbarë e suksese!

— Pastaj kryetari i lokalitetit nxitoi nëpër korridor. Mbetëm vetëm.

— Gjashtë orë më këmbë, do të lodheni pak — tha ajo duke buzëqeshur e duke qëndruar pranë dritares.

Të them të drejtën, pak më parë, kur ajo nxitoi të përgjegjej se xha Shaqoja do të vinte, m'u duk se nuk donte të më shoqëronte. Kjo zakonisht ngjet

me shumë vajza të moshës së saj. Po tani ndërrova mendje dhe e pyeta, duke e ndjerë vështrimin e saj, nëse do të më lodhnin apo jo ato gjashtë orë rrugë më këmbë.

— Ju vendase jeni?

— Po, jam pikërisht nga K, ku do të punoni ju.

Unë e vura re me vëmendje nga koka gjer te këmbët. Doja ta pyesja në ishte një kooperativiste e thjeshtë apo diçka më shumë. Ajo, sikur të kishte kuptuar mendimin tim, më tha:

— Jam mësuese. Ne dhe ju agronomët jemi si zogjtë — tha ajo dhe e hodhi vështrimin përtej xhamave të dritares, ku kishte filluar të shpërthente pranvera.

Vështrimin e kishte të qetë dhe në fytyrë i endej një buzëqeshje e ëmbël. Kushedi ç'mendonte. Zbritëm shkallët, drejt nesh erdhi një burrë rreth të pesëdhjetave, me një palë qillota e një setër shejaku të zi, duke tërhequr për kapistalli një mushkë trupvogël, të ngarkuar me gazeta.

— Tungjatjeta, shok, si të kam? — më pyeti ai dhe më zgjati dorën e ashpër.

— Falem nderit! — iu përgjegja unë.

— Po ti, Teftë, s'erdhe dot mbrëmë, ë? Të thashë unë që s'arrin dot, po ti... Në hotel fjete, ë?.. Te tezja? Mirë bëre, sikur u vemë përditë. Apo jo. mor djalë? — m'u kthye mua. — Te njeriu yt duhet vajtur nganjëherë, apo jo?

Unë aprovova me kokë.

— Ky është babai im — më tha ajo.

— Ashtu?! — i thashë unë i çuditur.

— Më kanë thënë të marr agronomin e ri këtu, mos jua panë gjë sytë?

— Po, ky është, baba.

— Aaa, po si je, o djalë? Nga Tirana të kemi? E paske bërë fora, më të lumtë! Unë jam korrieri i fshatit K, Shaqoja. E tashi mërr ç'ke për të marrë e mos u mbollis, se vajti dielli tre hostenë.

Unë ika dhe u ktheva me valixhen time, të cilën xha Shaqoja e ngarkoi në mushkë. U nisëm. Ai me mushkën për kapistre përpara, ne prapa.

— Do bëjmë udhë të mirë. Kur janë dy, i mbarojnë llafet, po një i tretë sikur i hedh gaz zjarrit. — Si tha këto fjalë, vuri nën sjetull zinxhirin e mushkës dhe u mundua të ndizte çibukun, por shkrepësja nuk i ndizej.

— Këto djall sikur i bëjnë që të mos ndizen. Që thua ti, djalë, u bashkuam pesë kooperativa. Na duhej edhe një agronom. Edhe mësues duhen. Ja, ime bijë që e sheh këtu, tani ka ardhur. Na u shtuan fëmija. E di sa mirë bëre që erdhe!

Mua m'u skuqën veshët e s'dija ç't'i thosha.

— Gjithnjë këtë rrugë bëni? — e pyeta.

— Çdo ditë e bëj. Tani që po mbaron xhadeja, gazetat do të vijnë gjer në fshat. Po do gjesh njerëz të mirë ndër ne, mos e ki hiç gajle.

Fshatari fliste shtruar.

— Më hoqën nga bujqësia, se s'ta mbarova llafin — vijoi ai pas pak. — «Edhe kjo punë është, më thanë. Bile me rëndësi të madhe, se s'ke vetëm gazetat për të marrë». Dhe më numëruan se ç'do të bëja si korrier. E, vërtet se mos vetëm gazetat marr. E kuptoj bre që është me rëndësi të madhe, po si të bëj unë që s'rroj dot pa tokën. Apo tani, që avullojnë ugarët nga qilizma! Le ta bëjë një tjetër këtë punë.

Ecëm dhe ca. Ai hipi në mushkë.

— Je i martuar? — pyeti.

— Jo — i thashë unë shpejt e shpejt. — As i martuar, as i fejuar.

Padashur, as unë nuk e di pse, e ktheva kokën nga vajza. Edhe ajo po më shikonte. Buzëqeshi.

Pas pak i ati mbështeti kokën mbi kapitellin e samarit dhe filloi të dremiste.

— Është lodhur — tha ajo. — Ngrihet që pa gdhirë.

Ne ecnim pas kafshës, që i hidhte hapat sipas qejfit. Ajo më shpjegonte pse nuk e lejonin babain e saj të punonte në bujqësi. Më çudiste çiltërsia e saj, të folurit e qetë dhe pa pengesa para të atit, buzëqeshja e gëzuar dhe pak e menduar, që nuk i hiqej kurrë nga fytyra. Duart i mbante më shumë në xhepat e pardesysë.

Mushka u ngjitej lartësive. Babai i saj flinte mbi samar, kurse ajo më tregonte për kooperativën. Fliste e qetë, buzëqeshte herë pas here dhe i ngulte sytë e saj në të mitë, sikur nëpër ta donte të depëronte thellë në mendimet e mia.

— Ç'njerëz keni? — e pyeta.

— Babain.

— Vetëm babain?

— Po, vetëm këtë — m'u përgjegj ajo e buzëqeshi. Po jo si zakonisht. Një si hije i mbuloi fytyrën. U shkoi dorën flokëve të verdhë, e treti vështrimin diku mbi pllajrat e gjelbëra me grurë dhe përsëriti:

— Po, vetëm babain!

Vargu i kodrave ishte i gjatë. Tutje, në malin e lartë, pranvera e dimri ishin përzier në mënyrë të mahnitshme. Në trupin e çdo druri të lartë kishte edhe borë, edhe gjelbërim. Qielli kaltëronte. Flladi

i lehtë na jepte ndonjë të rrëqethur. Kurse në kra-
hun tonë të djathtë, ku mali shkëmbor bëhej më i
thepisur, rridhnin ujëra të shumta. Unë mora frymë
thellë, i kënaqur nga kjo pamje. Udha tani ndahej
në dy degë. Ne morëm në të djathtë.

— Tjetra të shpie në mal — tha ajo. — Aty
marrim drutë dhe qerestenë.

Fjalët e qeta të vajzës i mbështjell në zhurmën
e saj një ujëvarë gjigande. Ujërat bien në një si go-
vatë prej guri të lëmuar dhe shkëlqejnë në ngjyra
spektri nën rrezet e diellit. Një avull i bardhë ngri-
het vazhdimisht lart.

— Sa ylber i bukur! — thashë unë i mahnitur.

— Këtu ai ka shtratin e tij — dëgjova mes
zhurmës zërin e saj të qetë.

— Sa ujë paska!

— Në verë pakësohet...

Qëndroj dhe sodis. Dora e njeriut ia ka ndë-
rruar rrjedhën shekullore dhe e ka futur ujin në një
kanal që gjarpëron gjatë rrugës. «S'e paskan prob-
lem vaditjen». mendoj unë.

— Ky quhet «Katarakti i xha Shaqos» — tho-
të Tefta me sy të shkëlqyer, ku pásqyrohet tërë ajo
mrekulli.

— I babait tuaj?

— Po i xha Shaqos, imi! — përgjegjet një zë i
trashë që më huton. Sa i trashë m'u duk zëri i
babait të saj! Sikur fliste vetë katarakti. Babai
kishte ngritur kokën nga kaptelli.

Zbriti nga mushka dhe e la të kulloste buzë
një mezhde me bar të ri.

— Ulemi të çlodhemi ca — tha ai.

U ulëm. Nxori nga torba një gjysmë bukë të

zezë dhe një tas druri me kapak (si duket të punuar vetë) plot me gjizë.

— Merrni — tha dhe filloi të përtypej.

Ajo po më shikonte. Unë mora bukë dhe po e haja thatë.

— Merr edhe pak gjizë. Kjo hahet këtu buzë burimit.

Mora. Mori edhe vajza. Burri i kishte ngulur sytë tek ylberi.

Po të të zihet buka, mbush grushtin me ujë dhe pi. Është ilaç. Po me avash, se të pret dhëmbët.

Xha Shaqoja ishte i menduar. Edhe ajo ishte e menduar. Mendoja edhe unë. Pse kishte emrin e tij ky katarakt i bukur? Xha Shaqoja u ngrit, piu duke u përkulur mbi rrjedhë dhe u hodhi dy grushta ujë syve. Vajza po e shikonte me dhembshuri. Në sy i pashë dy pika lot. Piva dhe unë. Edhe ajo piu. U nisëm. Ai nuk i hipi mushkës. E tërhiqte për kapistalli. Befas filloi të këndonte:

«Ftujkës së bardhë, o moj, me zile.
rrugës së maj malit kur vije...
leshëverdha, moj, trëndelinë...»

Vajza fshinte lotët dhe ecte pak prapa meje, si për t'u fshehur nga vështrimi im. Unë e shikoja me bisht të syrit.

— Po, mban emrin tim ky. «Katarakti i xha Shaqos» i thonë. Tërë krahina kështu i thotë — foli ai, si mbaroi këngën.

Sytë e tij ishin të egërsuar, thuajse nga çasti në çast do të shpërthenin në rrëke.

— Po, kjo është e lidhur me një histori. Të tërë këtej e dinë dhe e rrëfejnë këtë histori. Vetëm ti

nuk e di. Kemi qenë fshatarë të këputur, vërtet, të varfër sa s'kish më, po ama zemrën e kemi pasur plot, të gjerë, të pasur. I varfër kam qenë, shisja dru dhe rroja. Ushqeja edhe pleqtë, edhe motrat. Katër gomarë në ditë prisja. Po s'i shpija të tërë në shtëpi. Tre ia shkarkoja në oborr atij që kishte pyllin dhe gomarët. Ngrihesha në pikë të sabahut, sa dielli më zinte aty, ja e sheh ku jeshilon më shumë, dhe kthehesha aty nga darka në fshat. I pangrënë, herë — herë. Që i vogël këtë punë ë... e derisa më dirsi mustaqja. Pastaj, kur filloi lufta, dola në mal, partizan. E bëmë def armikun e të tjerët nga vatani. Fillova të vete përsëri në mal, por tani i lirë, të pres dru për vetë, për shoqërinë. Ndërtonim, ngrinim jetën e re. Nisesha pa dalë dielli. E shëh këtë fshatin këtu në këmbët tona? Ah, ky fshat!.. Më fal të pi një çibuk duhan.

Ai e ndezi çibukun. Sytë i mbante nga fshati.

— Po, kaloja nëpër këtë fshat, sapo këndonin gjelat e parë. Dielli qafonte majat e maleve kur arrija këtu, në «hamamin» tim. Herë shkoja vetë, herë me shokë. Po më shumë me shokë. Isha bërë goxha burrë. E de, në këtë ecejakë për në mal e njoha atë, gruan time, nënën e kësaj. Ajo, në një shfaqje që dha fshati ynë këtu, më kishte parë. Më kishte parë nga penxherja, kur luaja rolin e partizanit të plagosur. Më kishte pëlqyer zërin kur këndoja një këngë. Po ku ta dija unë? Pas kësaj, ajo më shihte çdo ditë, kur shkoja nga mali për në shtëpi. Po unë e pikasa vonë. A here nisa të vishem më mirë dhe ia merrja këngës sa tundej vendi: «Leshëverdha, moj, trendelinë...» Ajo dilte në penxhere e më buzëqeshte. Pastaj, më vonë, ma bënte me dorë. Po mora vesh se atë po e zhdëpnin në dru, se donin ta shis-

nin në një fshat tëlargët. Po e lija unë këtë!? Dërgova njerëz dhe e kërkova. Po më thanë: «Nuk ia japim atij vagabondi. Ai ka një bylyk me motra në shtëpi, do na e përpijnë çupën». Hë de, folë! Unë vagabondi, që kisha qenë partizan? E pse, se këndoja udhëve. Familja e saj ishte e varfër, po e ndershme, po ç'e do që hoxha atje ishte ulur këmbëkryq. Ja. E kërkova dhe s'ma dhanë, se unë isha i pafe. Sa s'pëlcisja. Ia thërrisja këngës bjeshkëve te katarakti, edhe në fshat.

«E kërkova, moj, po s'ma dhanë...» E di ç'bëra pastaj? E rrëmbeva. Një natë i dërgova haber dhe ajo erdhi me një bohçe sa një grusht. Ikëm. Krisën pushkët e të qarat e grave, po ne ikëm. Po asaj ia bënë benë. Do ta vrisnin... Dhe e vranë, ore, e vranë, këtu te katarakti e vranë, pas një moti të çupkës, të kësaj, ditën e parë të punës që do të hapnim këtë kanal për vaditje. Ajo ishte e vetmja grua vullnetare këtu. Se mos e vranë ata!.. Hoxha dhe ata të tjerët të barkut e vranë.

«Po vritet ylberi ndonjëherë, mor të zinj?» u thashë me atë në krahë — dhe fshiu me gisht një lot të madh, një lot të kristaltë. — Kështu puna. S'vritet ylberi. Popo plasi dashuria kudo. Pa le sa ikën nga shtëpitë. Tani ndryshe, s'kanë pse të ikin çupat nga shtëpia. Do ta ndez edhe një herë unë, ë...

Ai heshti dhe ne heshtëm. Shkonim nëpër fshatin e saj.

— Tungjatjeta, xha Shaqo! — e përshëndetnin. Ai u kthente përgjegjen. Vajza më tregoi shtëpinë e vjetër të nënës së saj.

— Djemtë e dajave që e vranë — tha ajo kur u derdhën drejt nesh ca fëmijë.

— Pse, flisni? — pyeta unë.

Ajo më pa drejt në sy.

— Kanë kaluar shumë vite që atëhere. Unë po mbush njëzet e dy. Kohët kanë ndryshuar — më tha. Ajo i puthi fëmijët dhe u tha: «Të fala...» Doleëm nga fshati dhe morëm tatëpjetë. Xha Shaqoja kishte mbështetur ballin mbi kaptell. Po unë isha i bindur se ai nuk dremiste.

— Tani e kuptova — thashë unë.

— Çfarë? — pyeti ajo.

— Pse babai juaj është kaq i çiltër me ju.

— Po nuk është e rëndë për të kjo rrugë? — e pyeta përsëri.

— Kjo e kënaq atë, megjithëse edhe bujqësinë e do shumë.

... Mushka zbriste tatëpjetë. Fshatari tundej mbi mushkë me kokën mbi kaptell dhe ne i vinim pas duke biseduar e menduar. Ajo fliste për kooperativën. Zëri i saj ishte i pastër, sytë e saj ishin të qeshur. Unë ndjeja flladin e mbrëmjes, të pranverës, që më përkëdhelte dhe një lehtësi e një siguri për ditët që më prisnin.

NË ÇADRËN E TRETË NJË USHTAR NUK FLE

Ishte natë shkurti. Bora binte flokë-flokë. Ajo shtronte çarçafin e saj mbi shpatin e malit, ku ngjiteshin ushtarët në kolonë. Era e ftohtë, që frynte nga veriu, sikur i ngrinte flokët e borës aty për aty dhe këmbët e ushtarëve rrëshqisnin në çdo hap. Ngjitja e shpatit të pjerrët të malit në një kohë të tillë ishte me të vërtetë e vështirë. Në kolonë kishte nga ata, për të cilët këto marshime ishin të zakonshme, por kishte dhe ushtarë të rinj. Ja, Nevruzi, mbyllësi i kolonës, e para tij Aliu. I pari ishte mësuar me këtë erë që të thante fytyrën, i kishte ngjitur disa herë këto shtigje, që ndërpriteshin nga shkëmbinj të thepisur e nga trungje të motshme. Veç pajimeve të tij, Nevruzi mbante edhe akumulatorin. E prapë edhe ai çuditet pse e ndjente veten kaq të këputur. Ç'ishte kjo lodhje që ia mpinte gjymtyrët?! Kurrë s'i kishte ndodhur kështu. Tri herë mallëkoi këmbët e tij që s'i zinin vend mbi shpatin e gurtë, të mbuluar nga çarçafi i borës, tri herë mendoi se, po të vazhdonte kështu, do të bëhej gazi i shokëve, tri herë tha me vete: «Mbahu burrë, kjo s'duhet të ndodhë! Ti je mbyllës, duhet të shikosh e të ndihmosh edhe të tjerët!» Po kaluan minuta dhe ja, ai, ende s'e zotëronte truoin.

Përpara ka Aliun, që është ushtar i ri, po me trup të lidhur; pushka e hedhur në krahun e tij, midis shpatullave të gjera, ngjan sinjë bastun i varur në një degë lisi. Po ky është lodhur më shumë. Kjo duket nga djersët, që i rrjedhnin mbi fytyrë dhe nga gulçimet, që lëshon herë pas here. Edhe ky mendon për këtë marshim. Po ama e ka bërë top: «Le të mbetem edhe prapa shokëve, po s'munda t'i ndjek hap pas hapi, por nuk do të ulem përtokë asnjë sekondë, nuk do të flas me asnjëri, nuk do të bëj asnjë lëvizje të kotë, gjersa të arrijmë në atë majën atje; atje mund edhe të këndojsi të tjerët, mund t'i kthej edhe ndonjë thumb Latos, që s'po na lë rehat». Kështu kishte vendosur ai me mendjen e tij dhe ecte, ecte pa kthyer kokën as anash, as prapa. Atë çast dëgjoji zërin e Nevruzit, po nuk iu përgjegj.

Ushtarët kishin kryer një marshim të gjatë, nën goditjet e «armikut», pastaj kishin kaluar në mbrojtje dhe një natë të tërë përgatitën pozicionet me profil të plotë. Në të aguar qenë hedhur në mësymje dhe e ndoqën «armikun» tërë ditën. Kështu kishin kaluar dy ditë në stërvitje. Dhe tani po ktheheshin në fushimin dimëror, disa kilometra larg, pas majës së malit.

Kolona po i qepej shpatit të malit. Gjer në majë kishin mbetur edhe disa qindra metra. Komandanti i togës dhe sekretari i organizatës së rinisë, Hamiti, erdhën nga kreu i kolonës në fund. Ata ndihmonin të rinjtë të arrinin shokët, i porositnin të mos shkëputeshin dhe pyesnin në ishin lodhur. Pyetjeve të tyre Aliu iu përgjegj vetëm me shenja, kurse Nevruzi me një buzëqeshje të lehtë. Ata përsëri nxituan hapat dhe kaluan përpara. Të fundit ishin prapë

Aliu dhe Nevruzi. I pari, si dhe gjer tani, as kokën nuk kthente prapa; i dukej se në botë, në këto çaste. ekzistonin vetëm dy objekte: ai dhe maja e malit. Kurse Nevruzi përsëri hante inat me vetëveten. Mendoi se do të kishte bërë mirë t'i kishte thënë komandantit të togës që ishte lodhur, ai do ta kish-te kuptuar, se një natë më parë e kishte parë vetë me sy tek kishte hapur dy pozicione, vetëm e vetëm që skuadra e tij të dilte e para... Mendoi se kot kishte dalë vullnetar për të marrë akumulatorin, gjersa ai i ishte caktuar një tjetri, por kafshoi majën e gjuhës, se iu duk sikur po e dëgjonin, megjithëse nuk fliste, por vetëm mendonte. Përpara nuk shquante më larg se tri metra. Edhe Aliun po e dallonte sa vinte më pak. Kish mbetur shumë prapa, apo ishte errur?

Këmba i rrëshqiti përsëri dhe gjuri iu përpoq te një gur i rrumbullakët. Ndjeu një të thehur të fortë, si t'i kishte ngulur njeri një thikë, po e mbajti veten dhe nuk nxori zë. U ngrit, mori akumulatorin, që kishte rënë në tokë dhe nisi të ecte. Duart i digjnin. Ato ishin grirë nga solucioni; bile, edhe rrobat, nën sjetull, aty ku mbante akumulatorin, i ishin grirë. Qepallat i rëndonin. Zuri të qeshte me vete. Gjumi i borës!.. Sa i ëmbël është ky gjumë! Sa i rëndë!

— Jo, jo! — u dëgjua zëri i tij i mbytur. Era e goi këtë zë në veshin e Aliut. Ky pothuajse e kishte arritur majën e malit, kurse pjesa tjetër e kolonës ishte varur poshtë.

— Hoopa! Ki kujdes! — iu përgjegj Aliu, se iu duk sikur shoku i tij, si që rrëzuar, kishte bërë titur: «O,o!» Këto ishin fjalët e para që kishte shquptuar ai.

Edhe Nevruzi i dëgjoji ato dy fjalë që shqiptoi Aliu: «Hopaa! Ki kujdes!»! «Po më kujtojnë që u lodha, mendonte. Po turpërohem në sy të shokëve... Unë, unë që dje u lavdërova si i palodhur... Ta marrë dreqi, ta marrë! Ç'është kështu me mua?» Tani kishte arritur pranë Aliut, e shikonte atë. S'kishte më fuqi, as këmbët s'lëvizte më dot, as duart.

— Ali! — foli me gjysmë zëri.

— E? — iu duk sikur iu përgjegj tjetri, po me gjysmë zëri!

— Të lutem, më ndihmo, merr akumulatorin...

— Edhe pak, edhe pak, se arritëm në majë.

Nevruzi në të vërtetë desh t'i thoshte ato fjalë Aliut, por as ai vetë s'e mori vesh pse nuk i shqiptoi. Sepse Aliu, në vend që të qëndronte, qe nisur.

Nevruzi mbeti prapa, kurse silueta e shokut të tij u zhduk në errësirë, disa metra më tej. Hodhi sytë lart. Maja ishte e mbuluar nga mjegulla, por ai e dinte mirë se shumë-shumë dhe dhjetë metra e do të gjendej mbi të. Drejtoi trupin, po iu morën mendtë dhe u përplas përmbys. Akumulatori i ra nga dora disa metra poshtë. Ktheu kokën pas rrëmbimthi, lëshoi trupin, rrëshqiti poshtë, derisa u pengua te një trung. Nuk u vra, se këmbët i takuan të parat në trung, po gjuri i djathtë i theri përsëri. Aty kishte mbetur dhe akumulatori. E mori në duar. Duart iu dukën si doreza të grisura. Solucioni kishte vepëruar shumë. I erdhi për të qeshur. «Po qesh me vete, mendoj. Sa keq kur qesh me vete!» U ngrit përsëri dhe herë gjunjazi, herë më këmbë, arriti nga ishte kthyer. Aty pjerrësia ishte më e vogël dhe, me shpirt në dhëmbë, u ngjit gjer në majë. Prej andej dukej qyteti, ku dritat e neonit shkëlqenin me qindra. Ç'pamje! Aty njerëzit prehen të qetë dhe

nesër do të çohen vonë, se është e diel, kurse unë po turpërohem këtu, në rojë të tyre...» Kështu mendoi dhe, pa e kuptuar as vetë, ra përtokë. A thua e zuri gjumi i borës të cilit i druhej aq shumë!?

Në këtë kohë, kreu i kolonës kishte hasur në një ortek bore. para Qafës së Dhelprës. Në krye, më më të fortit, kishin dalë sekretari i rinisë, Hamiti, Latoja, komandanti i togës dhe dy të tjerë. Toga e fundit e kompanisë tjetër kishte kaluar pak më lart dhe, siç dukej, ata do të qenë bërë shkak që orteku t'u zinte rrugën papritur ushtarëve. Po prej andej fushimi nuk ishte larg, prandaj ushtarët vunë të gjitha forcat dhe, megjithëse qe errësirë e plotë, rruga u çu. Në fillim ishin hapur fjalë se kishin humbur dy helmata, por pastaj u mor vesh se ato u gjendën aty afër. Dhe kolona mori rrugën për në fushimin dimëror. Komanda «Hap i shpejtë!» u pasua gojë më gojë. Tanimë, aty-këtu, dëgjoheshin dhe shakatë që bënin ushtarët me njëri-tjetrin. Mbi të gjithë dallohej zëri i Latos.

— Ato marshimet e mëparshme kishin qenë shëlitje para këtij...

— Po, vërtet. Kjo ishte stërvitje!

— E, or, e kemi zakon ne, sa herë që ndodhemi në marshime, themi me vete: S'ka më i rëndë se ky», pastaj e harrojmë kollaj atë që kemi hequr.

— Jo, jo, marshime të tilla nuk bëhen shpesh!

— Janë bërë dhe më të vështira — ndërhyri një tjetër dhe u kujtoi shokëve inkursionin e Brigadës së parë sulmuese gjatë Luftës nacionalçlirimtare.

Nga kreu i kolonës u përhap komanda «Pushim!» Ushtarët u ulën. Komandanti i togës ende nuk po

ulej. Ai shikonte vartësit një për një, herë-herë buzëqeshte, disa i porosiste që të mos zbërtheheshin, se mund të ftoheshin, ndonjë tjetri, që ishte gati të mbushte grushtet me borë e ta hante, për të shuar etjen, i kujtonte këshillat e mjekut. Po, kur pa Aliun, papritur bëri disa hapa përpara dhe u ul pranë tij. Ushtari as u mat të ngrihej. Dukej sikur trupi i tij qe ngjeshur fort përtokë dhe s'kishte fuqi të lëvizte. Po komandantin e shqetësoi më tepër pamja e fytyrës. Vetullat i kishte mbledhur, flegurat e hundës i ishin hapur pa masë, merrte frymë me gulçim dhe me dorën e djathtë, të bërë grusht, godiste tokën. Ishte i dëshpëruar që s'e kishte parë shokun prapa tij. Dukej si i sëmurë.

Gjithë pyetjeve të komandantit Aliu iu përgjegj me dy fjalë:

— Nuk di si më erdhi, po ja! — dhe kërciste dhëmbët.

— Që kur?

— Pasi kaluam ortekun.

— Ushtar Nevruzi! — foli komandanti dhe vështroi majtas e djathtas. Po ta kishte parë aty atë çast, do t'i kishte hequr një qërtim të rëndë, që s'e kishte lajmëruar menjëherë për gjendjen e shokut, por nuk iu përgjegj njeri. Të tjerët shikonin me habi, sikur donin të pyesnin: «Ç'u bë ky njeri?»

Ndërkaq Latoja ishte nisur me vrap për të kërkuar shokun, pastaj komandanti i togës nisi dhe Astritin, një ushtar të vjetër. Kurse aty, përpara këmbëve të komandantit dhe të ushtarëve të tjerë, që u mblodhën në çast, rrinte Aliu, gjithnjë me fytyrë përtokë. Aliu tani në mendjen e tij kishte krijuar qindra tablo, ku Nevruzi përleshej me pjerresinë dhe erën, i lodhur e i këputur, tek i thërriste për ndihmë, po ky bënte sikur s'e dëgjonte.

«... A thua vallë të më falet kjo?! Pse e bëra? Ai më kërkoi ndihmë dhe unë bëra sikur s'e dëgjova. E pse? Se kisha frikë mos lodhesha. E, po të lodhesha, ai do të ishte i pari që do të më ndihmonte, si gjithnjë. Dhe s'kam guxim t'u them shokëve që më rrinë në kokë të shqetësuar. Jo, s'kam guxim... S'e meritoj këtë kujdes...» Pastaj, i kujtoheshin netët që kishte kaluar Nevruzi me të, i kujtoheshin përpjekjet që bënte për ta ndihmuar që të kalonte brezin e kalitjes, nota e parë kaluese që mori në ushtrimin me hekur...

Komandanti i mori kokën në të dyja duart, i fshiu borën me pëllëmbën e ashpër, u ul aty pranë dhe nisi ta pyeste përsëri, ndërsa një tjetër shfaqqi mendimin ta merrnin në krahë dhe të vazhdonin marshimin. Atë çast erdhi mjeku i repartit nga kompania tjetër, që kishte zbritur në Përroin e Thattë dhe kolona u nis. Po Aliu s'pranoi në asnjë mënyrë ta ngrinin shokët. Mjeku tha se ai kishte nevojë për pushim. Aliu u nis me këmbët e veta, i shoqëruar nga dy shokë të tjerë.

Latoja dhe Astriti e kishin gjetur Nevruzin mu në majë të malit. Nevruzi ishte përmendur dhe tani e ndjente veten më mirë. Ai çuditej si kishte mbetur atje. Asgjë s'i kujtohej. Shokëve u tha se vetëm një çast e kishte ndjerë pisk, i kishte folur Aliut, ky i kishte dhënë kurajë dhe që nisur duke shpresuar se do të kishte ende fuqi të ecte. Pastaj, asgjë s'i kujtohej. Tani i dhembnin shumë duart, brinjët nën sqetull dhe gjuri i djathtë, nga i cili, po ta lëvizte, kullonte ende gjak. Latoja mori shokun në njërin krah, kurse tjetri pajimet e Nevruzit dhe u nisën...

Çadra, midis bardhësisë së pamasë, iu duk Nevruzit si një ndërtesë përrallore. Atë e zuri gjumi menjëherë. Në atë kohë, të gjithë njerëzit, bile edhe natyra, flinin: ushtarët në çadra, mbuluar me batanie, malet përjashta, mbuluar me borë. Vetëm era dhe rojet nuk po pushonin. Po edhe një ushtar, në çadrën e tretë, nuk flinte. Ai kthehej sa në njërin krah, në tjetrin. Dy herë i shkoi pranë roja e radhës e u mundua ta qetësonte, po ai s'i ktheu asnjë fjalë. Roja ishte e një toge tjetër dhe, siç dukej, s'desh t'ia hapte zemrën. Përseri iu kujtua Nevruzi që përleshej me erën, ajo thirrja që atij i qe dukur si rënkim... dhe përgjegjja e tij «Hopaa! Ki kujdes!...» I bënte vetes qindra pyetje dhe asnjërës nuk i përgjigjej dot. Pse nuk i qe dhënë ta ndihmonte shokun? A thua t'i qe dukur e vërtetë shakaja që kishte bërë Latoja në fillim të marshimit, kur pat thënë se, po të mbetej Aliu, si do t'ia bënin hallit, se ishte nëntëdhjetë kile? Në të vërtetë ai e donte Nevruzin, ia kishte për nder ndihmën që i pat dhënë, po edhe këto ndjenja ndrydhe-shin në atë shpirtin e tij të vogël. Duhej një zemër tjetër në atë gjoks të fortë, një shpirt tjetër, shpirti i madh i dashurisë së pakufishme për shokun, nga i cili të buronin dhe ndjenjat e vetëmohimit për vëllain e tij të armës. Dhe këtë tani Aliu po e kuptonte mirë dhe i vinte ndohtë nga vetja, i vinte turp nga shokët, i vinte tmerr kur kujtonte se të nesërmen, me të zbardhur dita, boria do ta ftonte në gjimmastikë dhe, në krah të tij, do të kishite Nevruzin. A do të qe e mjaftë të justifikohej me temperaturën e lartë që kishte pasur, me ethet që e kishin shtypur gjatë marshimit?

— Jo, jo! — tha dhe ndërroi krahun, gjithnjë i shqetësuar...

PARTIZANJA E ÇETËS SONË

«... Taibe Grabocka erdhi në çetë atë mbrëmje që ne kishim marrë urdhërin të bënim pritën, vazhdoi tregimin e tij oficeri me vështrim të butë, duke vendosur duart e rreshtëta mbi bankën e parë. Dukej e re fare, çupkë, i kishte a jo të gjashtëmbëdhjetat. Kërkonte komandantin. Ia treguam. Ajo kërkoi nga ai ta pranonte partizane dhe i dha një letër. Ne mërmëritëm. Pastaj u dëgjua një ze:

— Ti sa pushka je, moj e shkretë!

Deri atë ditë s'kishim pasur femër në repartin tonë. Komandanti ngriti sytë nga letra e sikur na përpiu me vështrimin e tij. Ishte trim, nga Labëria, me ca mustaqe goxha të gjata, por sa i dashur, aq dhe i rreptë. Ne ulëm kokën të turpëruar.

— Di të qëllosh, moj çupë e mbarë? — e pyeti ai me atë zërin e tij të trashë, që sikur dilte jo nga kraharori, por nga ndonjë guvë.

— Kam mësuar në grupin ilegal — tha ajo me një zë të hollë si prej fëmije.

— Është ca vështirë këtu në mal — tha komisarari.

— Kudo vështirë është sot. Edhe atje derdhet gjak.

Zëri i saj dridhej, ndërsa dora e bardhë dhe e brishtë, vazhdonte të qëndronte pezull në ajër, drejt qytetit me dritat e zbeta, që ndizeshin e shuheshin.

— Ti do të bëhesh një partizane e mirë — tha komandanti.

Vajzës së hollë e syzezë, me fustan të arnuar e këpucë të grisura, me fytyrë të hequr, i dhanë një palë rroba të vjetra të një robi e një palë këpucë të rënda ushtari.

Ajo kishte hyrë në radhët tona. E vetmja femër. E kisha në skuadër. Ecte prapa meje, tani që kolona gjarpëronte monopateve të heshtura.

Në kodrat e Kolonjës, vjeshta plot cingërima kishte filluar. Rruga që e gjatë. Toka ende nuk kishte ngrirë. Këmbët e zbathura shkelnin mbi llucën tërë akull. Dridheshim. Era na sulmonte nga të katër anët. Mblidheshim, po sa para bën! Të ftohtët na hynte në palcë. Ishim të zhveshur. Asgjë s'kishim futur në gojë. Objektivi i largët duhej arritur. Unë ndjeja dihatjen ritmike të vajzës. Edhe ajo dridhej. Bëmë tri minuta pushim. U ulëm. E shikova me bisht të syrit. Nga buzët i dilte afshi i ngrohtë i kraharorit e ndonië gulçimë lodhjeje. Hoqi këpucët e rënda. Çorapet e leshta i qenë skuqur. Këmbët i kullonin gjak. Dukej që kishte dhembje, se po i shtrembëronte tiparet e fytyrës. Po s'e bënte veten. Desha t'i flisja, po më vinte zor. Ajo s'e kishte hapur gojën që kur kishte filluar marshimi. Edhe komisarit, që e pyeti, iu përgjegj se ishte mirë. U ngritëm dhe vazhduam. Unë i dëgjoja dihatjen. Mendoja: «Kushedi si i janë bërë këmbët tani! Po duron, duron. Ta ibe e quajnë, ashtu tha... Është nga qyteti. E fortë paska qenë, bre!..»

Dhe orët kalonin. Kalonte dhe nata. Natë e kthjellët. Ndjeva një rënkim nga pas. Pastaj një peshë më rrëshqiti gjatë shpinës. U ktheva. Ajo kishte rënë përtokë. Shoku prapa po e ngrinte. Ajo ishte lodhur. Dridhej. Kishte dhembje. Natë. Ku po shkonim? Fshatrat ishin larg. E ngritëm në këmbë. Ajo

hapi sytë. Pse nuk e ndihmova të mjekonte këmbën?
Kur arritëm në bërrylin e rrugës automobilistike, po gdhijej.

Çeta u mblodh në një lëndinë. Komisari na foli për aksionin që do të bënim dhe komandanti ndau skuadrat nëpër pozicione, duke i dhënë secilit nga një detyrë. Taibeja nuk do të merrte pjesë në aksion.

— Jo — tha ajo. — Unë do të luftoj, prandaj kam ardhur . . .

Fytyra i qe vrejtur.

— Jo, s'do të luftosh — tha komandanti.

— Ti s'apo erdhe, pastaj ti s'mund të tërhiqesh shpejt, se të dhemb këmba — ndërhyri komisari.

Ajo heshti. Edhe ne heshtëm. Dikush tha:

— Ti mezi mbahesh në këmbë.

Ajo uli kokën, por menjëherë e ngriti. Në sy i pamë lot.

— Do të luftoj — tha ajo. Zëri i saj ishte i qetë, i vendosur.

Kur komandanti i tha se te partizanët kishte disiplinë, ajo heshti. Mua më erdhi keq për vajzën. Dukej aq e brishtë, sa na qe mbushur mendja se do të lebetitej kur të kërciste pushka.

Skuadra jonë ishte vendosur mbi rrugë. S'pritëm shumë. Ja, autokolona armike po afrohej. Maqina të mbushura plot me ushtarë, të plagosur, armatime e plaçkë.

Zjarri ynë qe i fortë. Nëntë maqina mbetën të gozhduara në vend. Skuadra jonë u hodh në sulm. Ata zunë pozicione të volitshme nën xhade. Shokët shkarkonin maqinat me armë, shollë, enë kuzhine, stolira e mjaltë . . . Në krah të tyre luftohej. Mbrohej ajo copë rrugë ku ishin maqinat. Gjermanët sulmuam në drejtimin tonë. Ishte afër një kompani. I

duhej bërë ballë. Duhej siguruar tërheqja e shokëve. Filluan të na qëllonin me mortaja. E kuptuan se nuk ishim shumë dhe nisën të na merrnin krahët. Andrea më urdhërojë t'u bëja ballë. U sula andej, hapa zjarr. M'u duk sikur u kositën të gjithë. Por u panë përsëri helmetat e mallëkuara.

«S'do t'i mbaj dot», mendova. Tërhoqa këmbëzën e shkrepjes. Por fishekët qenë mbaruar. Ç'të bëja? Shokët ishin në rrezik. Nxora bombën e vetme që kisha.

«Le të afrohen edhe ca», mendova.

Befas dëgjova një zhurmë shurdhuese nga e djathta. Gjermanët po vinin. Ktheva kokën dhe pashe Taibenë me një mitroloz të lehtë.

«Po kjo? Ku doli këtu?!» I thirra:

— Taibe! Ç'do këtu?

Ajo më pa dhe buzëqeshi si fëmijë. Se ç'tha, po s'e dëgjova dot nga zhurma e armëve. Më erdhi për të qeshur me fytyrën e saj tërë blözë. Kurse ajo ma bënte me dorë të tërhiqesha. Pastaj nuk më shikoi më. Vetëm qëllonte. Armiqtë binin. U zvarrisa në drejtim të saj. Ndjeva një dhembje të fortë në gjoks. Isha plagosur. Për një çast, vështrimi im kapi Taibenë, që qëllonte duke shtrënguar nofullat plot urrejtje, duke deformuar fytyrën, atë fytyrë aq të njomë dhe tërheqëse, majat e pemëve dhe një copë qiell të pastër, të pastër fare.

— Bjeru, Taibe, bjeru, mos i lërë!..

Kurrë s'do ta harroj atë fytyrë të dërsirë, sytë e saj të mëdhenj, që të vështronin me dhembje.

...Taibeja ishte tërhequr më vonë se shokët. Gjermanët, si kishin gjetur maqinat në flakë, i qenë ngjitur më lart xhadesë. Aty kishin diktuar 'Taibenë që më tërhiqte mua.

Shkurret i çirmin fytyrën, por ajo vazhdonte të ecte. Ishim të humbur, por në atë çast erdhën shokët në ndihmë. Gjermanët s'kishin guxuar të ngjiteshin më lart.

Afër drekës ndodheshim në Gërmenj, një fshat në jug të Kolonjës. Dielli kishte lëshuar rrezet e dobëta vjeshtake. Komandanti na përgëzoi për aksionin. Foli dhe për shoqen e re.

— Të lumtë, moj bijë! U tregove tamam trimëreshë shqiptare.

Ajo, gjithë gaz e krenari, tregonte se si gjatë betejës i ishte lutur komandantit dhe ky i kishte dhënë leje, se nuk ishte kaq i rreptë sa dukej në të parë.

Tërë ditën e kaluam bashkë me fshatarët. Taibeja nuk ishte më çupkë për ne. Ajo ishte luftëtare. Këtë titull e kishte fituar vetë, me luftën e saj.

Të nesërmen, ne të dy (i ishte enjtur këmba asaj dhe fytyra i qe gërvishur keq) shkuam në spitalin partizan. Kur u kthyem, shokët na pritën krahëhapur...

Kjo ishte një thërrime nga jeta partizane. Mos harroni, miqtë e mi, se ne të gjithë ishim jo më shumë se 18-20 vjeçarë. Dhe sot ndodhemi midis jush me rrudha në ballë e thinja në flokë... Këto janë kujtime të çmuara, që s'duhet t'i harrojmë kurrë.»

Oficeri psherëtiu. Një tufë rrudhash i qenë formuar në ballin e tij të gjerë e të rreptë. Klasa kishte rënë në qetësi. Të gjithë mendonin.

Mësuesja, një grua rreth të dyzetave, me tipare të theksuara dhe të ëmbla, me sy e flokë të zez e të shkëlqyer, buzëqeshte.

— Ama, ç'kam hequr me ty atëhere, Sami! Ku t'u kujtua pikërisht kjo ngjarje! — tha, kur mbeti vetëm me oficerin.

ARTISTET

Ata ishin gjithsej tridhjetë e pesë veta, këngëtarë, instrumentistë, vallëtarë, të veshur të gjithë me uniforma ushtarake. Ishin pjesëtarë të Ansambllit Artistik të Ushtrisë Popullore. Kishin plot dyzet ditë që shkonin në fshatra, në posta kufitare e reparte ushtarake. Në acarin e shkurtit, deri ato ditë kishin dhënë tridhjetë shfaqje. Sot këtu, nesër në një vend tjetër. Ecnin orë të tëra, rrugë e pa rrugë, me rrobat e veglat muzikore në krahë. Ai që ishte në krye çante borën me gjunjët, që i dridheshin nga lodhja, por vazhdonte të ecte. Vetëm kur vinte puna për të kënduar, atëhere të gjithë, duke ecur në njëshkolonë, ua merrnin me zjarr këngëve luftarake, atyre këngëve, që do të këndonin pas ca orësh para publikut. Vërtet ky ishte një turne i vështirë, i lodhshëm por ama i bukur, shumë i bukur. Një kënaqësi të dyfishtë ndjenim të gjithë nga bukuria e vendit, që ndodhej brenda kurorës së bardhë të maleve dhe nga mikpritja e ngrohtë e malësorëve. Lodheshin, por, kur në krye të fshatit apo në obo-rrin e postës kufitare njerëzit i prisnin buzëgaz, ata i harronin të gjitha. E këndonin me zjarr, mes duartrokitjeve e përgëzimeve me zë të lartë. Këndonin aty, në fushë të hapur, sa zëri kumbonte deri

tutje grykave, ku e shpinte era. Dhe mbrëmjeve, në shtëpitë e fshatarëve, ku kalonin natën, ata këndonin përsëri. Këtë radhë së bashku me pjesëtarët e familjeve. Kudo miq të rinj.

Turneut po i vinte fundi. Po kënga e tyre dëgjohej larg, në ato maja e gryka! Kështu thoshte edhe një nga këngët e repertorit të Ansambilit. Ata ngjitnin tani kodrën e fundit. Që poshtë shikonin një grumbull të madh njerëzish. Në fytyrat e artistëve endej buzëqeshja.

— Edhe këtu kanë dalë — pëshpëriti si e çlodhur një kërcimtare...

Ata ishin pesë kufitarë. Kishin një orë që vraponin tatëpjetë malit të lartë. Zbrisnin në fshatin ku do jepte shfaqje Ansambli i Ushtrisë. Njëri prej tyre, duke vrapuar, shikoi orën.

— Shpejt, shokë! — thirri ai. — Nuk do të arrijmë dot.

Ata nuk kishin mundur të niseshin më parë. Kishin qenë me shërbim. Ajo natë atje, në majë të malit, ku ata bënë rojë, kishte qenë shumë e ftohtë, me stuhi bore. Po ata kishin qëndruar të patundur. Dhe në mëngjez, kur koha u qetësua dhe mbaruan shërbimin, u kthyen në postë të gëzuar. U gëzuan më shumë kur komandanti i falënderoi dhe u tha të shkonin në shfaqjen e Ansambilit. Kufitarëve, të lodhur e të pagjumë, iu përtërinë forcat.

— Po shokët? — pyetën ata komandantin.

— Shokët menduan të shkoni ju.

Dhe tani ata vraponin drejt fshatit, ku do të jepej koncerti. Armët u lëkundeshin mbi supe dhe pjesët e tyre metalike bënë një zhurmë të mërzit-

shme. Po ata s'e vinin re. Dinin se kishin edhe dy orë rrugë për të bërë...

E ku i nxinte tërë ata njerëz salla e shfaqjeve të kooperativës! Se mos ishin vetëm njerëzit e atij fshati. Kishin ardhur edhe nga kooperativat e tjera, edhe nga postat kufitare e nënrepartet ushtarake kishin zbritur shumë ushtarë. Shpejt e shpejt u pastrua bora me lopata dhe artistët u bënë gati të fillonin koncertin. Shfaqja filloi. Në mes artistët, përreth populli. Kjo ishte një skenë e zakonshme për ato shfaqje. Aty nuk shuheshin dritat e sallës. Spektatorë e artistë e shihnin mirë njëri-tjetrin në sy, i buzëqeshnin. Buçitën këngët për Partinë, për ushtrinë e popullit ushtar, për kooperativistin dhe bijat e bijtë e tij që mbrojnë atdheun. Këndonin artistët. këndonin dhe spektatorët. Kërcenin artistët valle trimërie, aq të njohura për atë krahinë, rrihnin shuplakat të pranishmit që ishin rreth e rrotull. Ndonjë prej tyre hidhej në unazën e valles. Pas tij hidheshin edhe të tjerët. Vendi ziente nga gjallëria, duartrokitjet e të thirrurat e gëzuara.

...Ndërsa të pesë kufitarët vraponin tatëpjetë, drejt fshatit. Ata e dinin se, tashmë, shfaqja kishte filluar. Po, sidoqoftë, kishin shpresë të shihnin një pjesë të programit.

— Sikur një valle të shikojmë të paktën — tha njëri.

— Sikur të mos i kishim qepur qaforet! — tha i treti.

Të tjerët nuk folën.

Dhe të pesë kufitarët nxitonin me armë në krahe dhe me uniformë të pastruar, si për festë.

I janë larguar shumë postës. Këtu era nuk është aq e fortë sa atje lart, por, megjithatë, ajo fryn. Ata ndjejnë një gëzim të madh. Po i afrohen fshatit. Një kor i fuqishëm këndon për kufitarët që rrinë rojë ditë e natë. «Ee, në ato maja, mbron kufitari...». Ata buzëqeshnin. Gjokset u gufojnë jo më nga lodhja, por nga gëzimi, nga krenaria. Ata e kanë mësuar atë këngë. Kompozitori i saj ka qenë në postën e tyre. Fillojnë ta këndojnë dhe nxitojnë hapat...

Anëtarët e Ansamblit, të lodhur nga rruga dhe shfaqja, por edhe të gëzuar për suksesin, po çlodheshin të shtrirë mbi borë. Shumë fshatarë akoma nuk ishin larguar. Disa të rinj po ngarkonin në kafshët e kooperativës rrobat e mjetet e artistëve, për t'i çuar në një repart ushtarak, ku ata do të jepnin një shfaqje tjetër atë mbrëmje. Në atë kohë arritën në shesh me një frymë të pesë kufitarët. Fytyrat u skuqnin nga të ftohtët dhe cingërima. Djersët u rridhnin nëpër faqet e njoma. Dy prej tyre, kur panë që shfaqja kishte mbaruar, varën duart poshtë, si pa fuqi. Tjetri, duke mos e hequr dorën nga rripi i armës që mbante në sup, buzëqeshi dhe tha:

— Tungjatjeta, shokë!

Artistët dhe fshatarët, që i kishin parë kufitarët që larg ua kthyen përshëndetjen. Disa u ngritën në këmbë. Kufitarët ecën drejt grumbullit me njerëz. Ai që përshëndeti i zgjati duart; artistit të parë. Kështu bënë edhe të tjerët. Sytë e tyre ishin të qeshur. Kurse djersët akoma u rridhnin.

— Qenkeni lodhur — tha dikush.

— E megjithatë s'arritëm ta shohim shfaqjen!
— u përgjegj një nga kufitarët. Në zërin e tij diri-

gjenti ndjeu më shumë pikëllim se sa një keqardhje të zakonshme.

— Por mjafton që ju pamë, — tha një kufitar tjetër — zëri juaj dëgjohej gjer lart fare qartë.

Të gjithë artistët ishin mbledhur rreth kufitarëve. Bora në këmbët e tyre po shkrinte.

— Nga vini? — pyeti një vajzë e bukur.

Kufitarët nuk dhanë përgjegje. Njëri përtej tyre buzëqeshi, tjetri rregulloi armën në sup, i treti fshiu djersët... Artistja kafshoi buzën e turpëruar, pasi e dinte që ushtarët nuk tregojnë gjëra të tilla. Nga-çë s'kishte ç'të bënte, rrotulloi nëpër duar me dorëza të zeza kapelën e saj ushtarake. Megjithatë ajo hodhi vështrimin nga majat e maleve plot borë, të cilat mezi dukeshin që aty. Buzëqeshi. I pa me admirim kufitarët dhe pastaj u kthye nga shoqet e shokët e saj. Udhëheqësi artistik iu lut fshatarëve të shkarkonin kafshët dhe urdhëroi trupën të mblidhej.

— Uluni shokë. Ju jeni të lodhur — u tha ai kufitarëve.

Këta u ulën këmbëkryq mbi borë, me armët në prehër. Filloi përsëri shfaqja. Buçiti përsëri kënga, më e fuqishme, më e gëzuar. Fshatarët u çuditën. Filluan të dilnin nga shtëpitë. Grumbulli i atyre që rrinin në këmbë prapa kufitarëve shtohet e shtohet...

LUMTURIA

Në këtë qytet, në breg të Devollit, të fshehur në thellësi të maleve, që duken sikur janë vocërrakë të Tomorrit, çdo gjë të duket e qetë dhe e heshtur, edhe rruga e vetme, ku mbrëmjeve njerëzit bëjnë shëtitje, edhe dritat e porsamontuara të neonit, edhe bari e lulet, që përhapin gjithkund një aromë të ëmbël e dehëse.

Ky është ende një qytet i vogël. Dhe në qytelet e vogla njerëzit bëhen kureshtarë për çdo gjë. Asgjë e re nuk mund t'i shpëtojë syrit të tyre.

* * *

Hëngra drekën dhe u ula në verandën e bar — lulishtes së vogël për të pirë një arançatë. Që poshtë dëgjohej oshëtima e rrjedhës së lumit, si dhe fëshfërima e plepave të rinj, të mbjellë brigjeve.

«Vapë e madhe, mendova, po thahen fare grunjërat!»

E treta vështrimin larg, gjatë rrjedhës së lumit. Atje te gryka më kapi syri shumë njerëz, që ishin zhveshur tamam si në plazh dhe laheshin e

loznin me top. Të tjerë rrinin grupe — grupe shtrinë në rërën e ngrohtë. Buzëqesha. Ajo kumish-te e gjatë dhe e ngushtë më sillte ndër mend disa ditë të paharruara të jetës sime, një ngjarje të kaluar, që nisi këtu e dy vjet më parë, kur unë erdha e u vendosa në këtë qytet bashkë me time shoqe. Lumturinë.

Sapo ishim diplomuar të dy atë vit. U martuam dhe transferimi në këtë qytet të largët e të vogël nuk na shqetësoi. Këtu mund të jetonim dhe të punonim për bukuri, me dashurinë tonë për punën e për njerëzit.

Dimri i parë kaloi mirë. Puna na lidhi e na bashkoi shumë edhe me vendësit. Fshatarët e kooperativës, matanë lumit, ku Lumturia jepte mësim, flisnin me respekt e dashuri për mësuesen e tyre, megjithëse ajo «u kishte rënë në qafë» për shkollën e natës dhe për aktivitetet kulturele e artistike. Lumturia ulej këmbëkryq me ta rreth vatrës dhe, midis fjalës e shakasë, u fliste për higjenën, për mënyrën e kulturuar të jetësës. Të them të drejtën, unë çuditësha me gruan time. Ku e gjente ajo tërë atë forcë për të tërhequr njerëzit, për të fituar besimin e tyre?

Erdhi vera me ditët e nxehta. Këtu bën shumë vapë. Duket sikur dielli i përqëndron të gjitha rrezet në këtë gropë.

Lumturia u kthye një ditë nga fshati shumë shpejt. Fustani prej basme i ishte bërë qull në djersë.

— S'durohet kjo vapë! — tha ajo.

— Ja, sa të marrim lejen dhe do të freskohemi ca — i thashë si me shaka.

— Ato pesëmbëdhjetë ditë janë, ndërsa vera

është tre muaj. Është mirë të shkojmë e të la-
hemi në Devoll... apo s'ka edhe një vend të mirë...

— Ç'thua, Lume? Mos jemi në Durrës këtu?

— Pse, ç'ndryshim ka? — më pyeti ajo e çuditur.

Unë nuk iu përgjegja. Buzëqesha e mendova:
«Ç'ndryshim ka, pra? Se këtu është lumë e atje
det?»

— Po a nuk e shikon se këtu shkojnë në lumë
vetëm kalamajtë? — i thashë pas pak.

— Le të jemi ne të parët. Në çdo gjë duhet
të jetë një i pari...

— Lëri këto tani, Lume! A do të shkojmë të
shohim filmin e ri sot?

— Në film do të shkojmë... Por edhe nesër
në lumë, ama!

— Mo, po ty të është bërë mendja top. Do që
të na varin ndonjë teneqe prapa!

Fillova të shqetësohesha. Ajo e kishte me gjithë
mend. Të rrinim e të merreshim me ngatërresa ta-
ni! Këtu kishte kaq e kaq njerëz dhe ne, që sapo
kishim ardhur, të nisnim nga këto. Do të thonin:
«Ja, inteligjenca, filloi!» Ç'është e vërteta, unë e
kuptoja se këtu nuk kishte asgjë të keqe, por...
ambienti, vendi, njerëzit, gojët e liga, të gjitha këto...

— Ç'mendohesh, inxhinier!? — ma ktheu ajo
me ironi. — Luftë mendimesh? Ku e ke atë dialek-
tikën tënde? Një gjë kaq të thjeshtë nuk e zgjidh
dot! Kështu çan përpara ti?

— Sa për të çarë përpara, të kam lënë ty,
shoqja mësuese, se ju mësuesit e çoni të renë në
fshat! — u mundova unë ta qesëndisja.

— Epo mirë, pra, — ma priti ajo — atëhere
unë po çaj. Nesër në «plazh»! — Ajo qeshi dhe
doli nga kuzhina.

— Shiko, se do të na hapësh avaze!

— Fillove prapë ti? Sa i lëkundur që je! —
dëgjova zërin e saj nga dhoma e gjumit.

— Epo, të dalë ku të dalë! — thashë me gjysmë zëri.

Nuk isha i vendosur, por edhe ënda ma kishte të lahesha.

Të nesërmen të dy shkuam në buzë të lumit dhe, pasi u zhveshëm, u shtrimë në rërën e përvëluar. Uji rridhte i kulluar. Ishte një ditë e ngrohtë, që na bëri të shijonim freskinë e ujit.

— Në Durrës ka aq shumë njerëz dhe kanë aq pak vend! Ne të dy kemi një «plazh» të tërë! — bënte shaka e qeshte Lumja.

Shkuam edhe herë të tjera buzë lumit për t'u larë, sa herë që kishim kohë të lirë.

Por, ndërsa ne punonim, mësonim, dëfrenim e shkonim në lumë për t'u larë, fjalët kishin filluar të dilnin e të përhapeshin në tërë qytetin. Vetëm ne nuk dinim gjë. Një ditë, tek po laja duart pas punës. më erdhi pranë një plak, burrë i mirë. që e njihja prej kohësh.

— Kam dashur të të them nja dy fjalë më parë, por më vinte rëndë, shoku inxhinier! — më tha me drojtje. — Të kam si djalin tim e s'më rrihet!

— Folë, xha Sali, si është puna?

— E kam fjalën për atë... lumin... flasin, more djalë...

E kuptova se ku rrihte plaku. Më foli gjatë dhe unë nuk e di sepse, nuk isha në gjendje t'i ktheja përgjegje.

— Vend e kuvend, djalë! — e mbylli ai dhe iku.

Unë e falënderova. Por koka më ziente, ama Tëmthat më rrihnin si çekan. «Unë të bëhem gazi i botës!..»

Shkova drejt e në shtëpi. Se ç'do të bëja, nuk e di, por, kur vajta aty dhe i vura çelësin bravës, mendova: «Ç'budalla! Si e lëshova veten dhe dëgjova marrëzitë e sime shoqeje?»

Unë e di si e kam pritur atë ditë Lumturinë. Ajo erdhi e qeshur dhe e djersitur, si gjithnjë.

— E? — i thashë me qesëndi. — Mos ke qejf për një banjë në lumë?!

Ajo shtangu. Por ky qe vetëm një çast. Pastaj buzëqeshi.

— S'do të ishte keq, por ç't'i bëj, se kam ca detyra për të korrigjuar.

— Shiko, Lumturi, për të shkuar në lumë mos më thuaj më!

— Ke frikë se mos nxjerrin fjalë për mua?

Ajo ishte aq e qetë, sa unë për një çast pyeta veten se përse isha nevrikosur. Më shikonte në bebëzat e syrit.

— Shiko, Fitim, t'i s'ke pse të shqetësohesh për ato që thonë njerëzit. Ne s'po bëjmë ndonjë turp.

Unë s'foli aty për aty. E kuptoja se ajo kishte të drejtë.

— Ne s'duhet të thyhemi para kësaj vogëlsie. Kjo që bëjmë ne është e re në këtë vend. Ç'kuptim do të kishte jeta, po të stepeshim para asaj që është e drejtë dhe e mirë? Më duket e tepërt të flas për ato që vetë m'i ke thënë sa herë...

Diskutimet tona vazhduan disa ditë. Dhe unë, kur e dëgjoja të fliste me zjarr e me zë të lartë, më vinte mirë, sepse shikoja te gruaja ime një mbështetje të sigurt në jetë. Ajo kishte të drejtë, por

prapë mendoja se pse të ishim ne të parët, pse të bëheshim me fjalë, kur mund të jetonim të qetë, me dashurinë tonë e me respektin e të tjerëve. Këto u mundova t'ia shpjegoja dhe asaj.

— S'na duhet respekti dhe dashuria e përciptë — tha ajo.

— Moj, ti ke të drejtë, por...

— Pse, «por», Fitim? — ma preu ajo. — Kur kemi të drejtë, atëhere s'ka përse të druheni...

— Unë, unë, nuk do të vij më të lahem — i thashë.

— Atëhere unë do të shkoj vetë! — tha ajo e vendosur.

Ajo, vërtet, mund të shkonte të lahej edhe vetë. Dhe kështu ne shkuam të laheshim të dy.

Pas kësaj disa njerëz nuk na përshëndetnin më si më parë. Kurse Lumja thoshte se po haste pengesa me nxënësit. Fshatarët kalonin rrugës kokulur dhe thoshin vetëm kaq:

— Mirë dita!...

Një ditë gjetëm nën derë një copë letër pa emër.

«Mos na ndyni zakonet e vendit. Këtu nuk jemi jashtë shtetit!»

Ajo e mori, e lexoi dhe qeshi.

— Tani mund të themi se filloi lufta — tha ajo. — Dikush po shqetësohet shumë.

E mblodhi letrën në shuplakë të dorës dhe e flaku.

Unë s'fola. Edhe unë isha shumë i shqetësuar. Po ç'ti thosha? Ta ndaloja? Të tërhiqeshim? Kjo edhe mund të bëhej, por edhe mua nuk ma kishte qefi tanimë të tërhiqesha, se do të thoshin se ne ishim trembur.

Lumturia filloi të vinte më herët në shtëpi. Kjo më ra në sy menjëherë.

— S'kam më punë — më tha e mërzhitur. — S'vijne fëmijët as ditën, pa le pasditeve. Nxjerrin lloj-lloj arësyesh. Një nxënëse më tha se nuk e lë babai, sepse i nxjerr mësuesja në gjimnastikë me mishra jashtë që t'i bëjë si veten.

— Më duket se u shpejtuam — i thashë. — Ç'do të bësh tani?

— Si ç'do të bëj? Mos kujton se do të trembem?

— Çfarë njeriu paske qenë! — thashë i mërzhitur. — S'të marrka vesh koka, xhanëm? Ç'fiton ti në këtë mes?

— Më duket se s'do të prishësh qetësinë familjare, inxhinier!

Ironia e saj më therte. Të mos e doja aq shumë e të mos e njihja, nuk di se ç'do të kisha bërë!

— Mos harro se do të vijë një ditë që ne do ta humbim monopolin mbi «plazhin»... — Ajo fliste e qetë, shumë e qetë dhe mua më vinte inat se si ishte e mundur të mos më kuptonte dot. Pse t'i merrte gjërat kaq thjesht?

Pas tri ditësh unë shkova të merrja Lumen në fshat. Më shqetësonte vonesa e saj. E gjeta në zyrën e drejtorit. Nuk ishte vetëm. Ndodheshin aty sekretari i organizatës së partisë, nja dy fshatarë, drejtori dhe një inspektor i seksionit të arësimit, si dhe kryetari i kooperativës. Më ftuan të hyja brenda.

— Është mirë të jesh edhe ti — më tha kryetari.

Inspektori e të tjerë aprovuan me kokë.

— Si është puna? — pyeta unë, megjithëse e merrja me mend se përse bëhej fjalë.

— Është ngritur i tërë fshati. Qahen për tët shoqe. Thonë se mësuesja po ua prish fëmijët — tha kryetari rëndë-rëndë.

Kryetari ishte një burrë i shëndoshë, të cilit duke sikur nga çasti në çast do t'i pëlçisnin faqet.

— Po ju si mendoni? — e pyeti drejtori, të cilin e njihja prej kohësh, se bashkë kishim ndjekur universitetin.

— Unë? Po ja, bre burra, si të them. Unë jam me fshatin...

— Ndreqe pak, shoku Kadri! Jo gjithë fshati, por nja dy a tre, që gjithmonë na kanë hapur telashe të tilla... — ia priti aty për aty sekretari i partisë, që, po ta vëreje nga shtati, dukej qesharak para kryetarit.

Lumja dëgjonte e heshtur. Një cipë e kuqe i kishte mbuluar fytyrën.

— Ne duhet t'u mbyllim gojën një herë e mirë këtyre njerëzve — vazhdoi sekretari i partisë. — Kush foli atëhere kur nisëm vajzat për në kurset e uzinës, apo në hekurudhë? Po tani, ç'thonë fshatarët për këto? Për ta është nder, që fëmijët e tyre punojnë në uzinë, apo kur kthehen ballëlartë nga hekurudha.

Unë isha ulur në karrige dhe dëgjoja. Puna nuk ishte aq e thjeshtë.

— Çdo gjë bëhet më kohë dhe jo «bam», — e mori fjalën inspektori i arësimit. — Unë jam vendës dhe i njoh mirë zakonet e këtyre anëve. Janë zakone që janë ngulitur në shekuj...

— Po t'i gjykojmë gjërat kështu, atëhere duhet të mbetemi në vend. Ju gjykoni si konservator, shoku inspektor dhe i shikoni gjërat nga zyra. Vërtet jeni nga ky fshat, por kushedi sa kohë

keni që nuk keni shkelur, veç për vizita të tilla, — foli qetë Lumturia.

— Unë përfaqësoj këtu mendimin e institucionit epror dhe...

— S'e besoj të kenë të gjithë këtë mendim! — tha ajo.

— Po ju ç'thoni? — më pyeti mua sekretari i partisë, që po buzëqeshte.

Rashë ngushtë. As që isha përgatitur për një gjë të tillë. Por, edhe të ngrija supet, nuk ishte mirë.

— Ç'mendoj unë? Këtu puna është e qartë. Nuk mund të presim shekuj gjersa të nguliten vetvetiu të tjera mendime te njerëzit tanë. Kemi edhe shumë punë të tjera për të bërë.

Kjo, si duket, ishte një shuplakë e mirë për «përfaqësuesin e institucionit epror», sepse iu skuqën edhe veshët.

— Sidoqoftë, unë s'jam konsultuar për këtë me shefin, — tha si nëpër dhëmbë.

— Vëre në plan e pastaj bisedoje me të, — tha një fshatar i ri, me të qeshur.

Të gjithë vunë buzën në gaz.

— Këtë do ta bisedojmë edhe me shokët e partisë në rreth, — tha sekretari. — Nuk është kaq e thjeshtë. Ta shtrojmë edhe në popull, se këto punë i zgjidh populli.

— Punë e koklavitur! — tha kryetari, duke dredhur cigaren.

— Jo, mor shoku kryetar, — tha drejtori. — Në fillim kështu është. Por do të shikosh sa mirë do të venë punët. Ti vajzën tënde a e le të bëjë gjimnastikë?

— Po qe për timen...

— Po ja, jotja, imja e me radhë. Edhe anëtarët e bashkimit të rinisë do të na ndihmojnë, apo jo, o shoku Qani?

— Që ç'ke me të! — tha djaloshi. — Bile se si kemi fjetur deri tani, çudi na vjen.

U ngritëm. Kryetari më ra supeve.

— Ta vonuam ca sot nusen, or djalë, na e bëj kabull. Ke marrë çupë të mirë...

— Po ato njëzet metrat e basmës për kilotat e vajzave s'po na i merr, ama — i tha me të qeshur Lumja.

— Eee! — kruajti kokën kryetari.

— Epo mirë, se po i blej me lekët e mia... sepse, si duket, ju vjen keq për lekët... — e thumboi përsëri Lumja.

— He, shejtan çupë! Ashtu u bëftë, si thua ti! Nesër dil nga llogaria.

— Fjalë burrash?! Toke! — edhe i zgjati dorën e saj të vogël pëllëmbës së trashë e braza-braza të kryetarit.

Kryetari qeshi e, duke thithur thellë tymin e duhanit. doli përjashta.

Atë ditë u gëzuan më shumë se çdo ditë tjetër. Kur po ktheheshim për në qytet, morëm tatëpjetë zallit të lumit me këpucë në duar. Ishte errësuar. Na kishte pushtuar zemrën një lehtësi e madhe.

— Je penduar për atë që the atje? — më pyeti Lumturia.

— Pse?

— Se ashtu e ke ti, s'do që të biesh në sy, ndonëse mendimet i ke të mira! — dhe qeshi.

Qesh e ngjesh, i thonë kësaj fjale. Unë s'fol. E zura për dore dhe e detyrova edhe atë të vraponte tatëpjetë lumit, duke spërkatur kështu njëri — tjetrin

me stërkalat, që hidheshin përpjetë nga rrahja e hapave tonë.

Pas kësaj dite na u bë me e lehtë puna. Na erdhën në ndihmë vajzat e atij fshati, që punonin në uzinë, arësimtarët dhe disa të rinj të tjerë. Të dielave, fill pas punës vullnetare, shkonim të gjithë në lumë. Dalëngadalë, kjo u bë e zakonshme; filluan të vinin punëtorët me familjet e tyre. Tani «plazhi» ynë mbushet plot. Edhe fëmijëve të shkollës filluan t'u mësonim not. Bile sivjet përgatitet një skuadër notarësh për të marrë pjesë në spartakiadën e të rinjve.

Një ditë Lumturia më tha:

— Të pata thënë se do ta humbnim «monopolin»!

Me të vërtetë e humbëm «monopolin» dhe kjo ishte fitorja më e madhe për ne.

*
* *
*

Ky është një qytet i vogël rrëzë maleve, që jeton çdo orë me vrullin e punës, me të renë, që hyn e papërmbajtur në rremba e në gjak dhe e përhap ngrohtësinë e vet në të gjitha skajet e kësaj krahine. Çdo gjë këtu është e re dhe ka historinë e vet të re. Historia e tij është lufta dhe triumfi i së resë mbi të vjetrën. Dhe këtë luftë e bëjnë çdo ditë njerëzit e rinj e të mrekullueshëm të qytetit, ata që s'dinë ta mbajnë kokën prapa perdeve, po vijnë të çiltër te ti, të japin dorën dhe të vështrojnë drejt e në sv.

MËSIM NGA NJË NATE

S'kam për ta harruar atë natë. Më kritikuan aq sa s'e prisja! Dhe as që u bëhej vonë se unë kisha qenë mësues, se moshatarëve të tyre u kisha dhënë mësim. Ata, atë mbrëmje, nuk pyesnin fare për «profesorin». Për ta unë isha vetëm një ushtar, një ushtar që i pengonte në arritjen e objektivit.

Ja, kështu më thanë atë natë. Ishte natë dimri me borë. Jashtë toka zbardhte. Duhej të gërmoje gjysmë metri, që të gjeje dheun e zi e të ngrohtë në ato kodra ku pas dy orësh, do të zhvillonim stërvitjen taktike! Ata më kritikonin se i bëja bisht stërvitjes. E, kur u thashë se unë nuk isha mësuar me këto vështirësi kërcyen më keq. «Jo, thanë, ti ke qenë arsimtar dhe arsimtarët që njohim ne, bëjnë sakrifica». Vetëm Ismaili nuk fliste. Dhe ata iu kthyen atij. «Edhe ti nuk bën mirë që nuk flet. Pajtohesh me të?»

Ismaili, një djalë zeshkan, është tepër i heshtur. Për nga goja nuk ia thotë, por për punë e për stërvitje, nuk e di se ku e gjen atë forcë, atë frymë, atë durim. Vetëm aty bëhet tjetër njeri. E, megjithatë, ai nuk foli atë mbrëmje. Ishte i vetmi njeri që nuk foli. Rrinte kokulur. Ndoshta i vinte rëndë ngaqë kishte respekt për mua. Unë i kisha dhënë mësim në një

kurs e, tani, gjithnjë i shpjegoja temat nga Historia e Partisë. Më pa vetëm një herë. M'u duk sikur tha: «I shkreti ti, mërdhin, lodhesh, ta qaj hallin!». Dhe nuk po më fliste as gjatë kohës që po sulmonim drejt «armikut». Ç'mendonte vallë, më përkrahte, apo më përbuzte? Në një kohë tjetër as do ta vrisja mendjen se ç'mendonte një Ismail, të cilit i shpjegoja çdo pasdite mësimin politik dhe arithmetikën. Po s'di se pse njerëzit e heshtur më shqetësojnë shumë. Nganjëherë këta, me heshtjen e tyre, thonë më tepër se ata që flasin. Stërvitja kishte filluar me kohë dhe ne ishim lodhur. Borën e çanim me gjoks. Nxinin vetëm konturet e zhveshura të pemëve. Pastaj kudo bardhësi.

Ishim tre veta, Ismaili, unë dhe një i tretë. I drejtoheshim mitralozit «armik», që pengonte veprimet tona. Ai duhej asgjësuar. Kjo ishte detyra jonë. Era na përplaste mbi fytyra borën, sa mezi merrnim frymë. Deri në një farë vendi, «armiku» na vrojtonte. Na kishte si në pëllëmbë të dorës. Ne duhej të bëheshim një me borën. Filluam ta çanim atë me mjekër. Herë pas here unë ngrija kokën të merrja frymë dhe shihja nga Ismaili.

Nuk ishte e lehtë ta kaloje atë copë vendi. Po unë kisha vendosur që të mos thyhesha. E vështirë ishte, po fjalët e shokëve në mbledhje më rrihnin ende në kokë si të goditurat e një vareje. Edhe hesh-tja e Ismailit më digjte.

Objektivi që duhej të asgjësonim ishte në kodrën përballë. Më merrej fryma dhe gjymtyrët sikur nuk i kisha të miat, pa le dora që mbaja armën. Ishte ngjitur pas metalit të akullt. Po i jepja zemër vetes. Eh sa lehtë ishte të shkruaje parrulla në dhomën e kulturës, apo të bëje një recension! Sa me qejf i merrja

për t'i bërë ato, vetëm e vetëm që të mos vija në taktikë! Po, tani e tutje, ato duheshin bërë jashtë orarit të stërvitjes.

Duhej kaluar një përrua e pastaj të ngjiteshim lart. I vogël ishte përroi, po, sidoqoftë, ishte përrua plot me ujë. E uji nuk dukej, se e kishte mbuluar një shtresë e hollë akulli, dhe akullin bora. Këto i dinim mirë ne. Përgjegjësi i grupit na bëri shenjë të ndaleshim. «Do ta krahëmarrim, tha me zë fare të ulët. Ti nga e majta, unë përballë, kurse ti dili prapa, mirë?» Toni i tij ishte i prerë. Bënë «po» me kokë.

Ecëm përsëri përpara, duke u larguar në krah të njëritjetrit. Një shuk bore u rrëkëllye para meje. Ktheva kokën nga ai. Dora i tundej në ajër. Ma bënte me shenjë të ecja më shpejt. Aty vendi ishte i thyer dhe «armiku» nuk mund të na vrojtonte. Megjithatë, ai kërkonte që të vazhdonim të maskoheshim. Njëherë tjetër do të më kishte ardhur për të qeshur me veprimet e tij. Por unë ndjeva respekt. Dhe e kuptova se ky respekt nuk ishte vetëm ngaqë kishte hequr në mbledhje. Jo. Kurrë më parë s'më kishte rënë rasti të isha pranë tij, në stërvitje. Kishin hak që e lavdëronin. Që atë çast mendova se si do ta ndërtoja stendën e re të emulacionit. Ndërkaq s'po mendoja për lodhjen dhe të ftohtët. Kur po zbrisja në përrua dhe vrisja mendjen se si të futesha në ujë, pashë se silueta e tij ishte buzë një gremine, që binte thikë drejt e në përrua. Nuk ishte më pak se pesë metra lart. I bëra shenjë të shmangej, por ai mohoi. U afrova, megjithëse ai kundërshtonte.

— Kalo anash — i thashë. — Është shumë e lartë, do të vritesh.

— Këtu më ra drejtimi. Jemi në situatë luftarake.

— Stërvitje është, të shkretën — thashë i pakënaqur.

— Po atëhere ç'kuptim do të kishte stërvitja? Lodër fëmijësh? Fëmijë jemi ne apo ushtarë?

Ma mbylli gojën.

— Ja, kështu mund të na ndodhë në luftë. Lufto tani. — Sytë i xixëllonin kur fliste. — Pse, ti nuk do të kaloje këtu, po të ishte kjo pengesë në sektorin tënd?

Dhe, papritur përgjegjen time, fluturoi poshtë shkëmbit. Mua m'u drodh zemra dhe se pse ndjeva shumë vapë. Kjo ishte krejt e befasishme. Njeriu të paktën e mat me sy vendin ku hidhet. U hutova. Një zhurmë. Akulli u ça. Diçka llokoçiti. Ca degë aty poshtë u shkundën nga ngarkesa e borës dhe nxinë. Unë vrapova duke thirrur: «Ismail, Ismail!». S'u përgjegj njeri. Sakaq u ndodha aty. Ai kishte dalë nga ujët dhe mundohej të mbahej pas një ferre, mbirë rrëzë shkëmbit. Në fytyrë ishte gërvishur.

— Mos thirrë! — më tha rreptë. — Je në situatë luftarake.

— U vrave? — e pyeta i shqetësuar.

— Asgjë — tha dhe më zgjati dorën, me të cilën mbante armën. Doli. Nga një këmbë çalonte. Ish-te bërë qull. — Paska goxha ujë, djalli.

— Gjuri? — e pyeta.

— U vrava ca — u përgjegj ai duke shtrënguar nofullat. — E, kalohet apo jo? S'm'u përgjegje qëparë — më tha pas pak.

— Kalohet, — thashë — kalohet. Edhe unë do ta kaloja...

— Po, ç'u mblodhëm kështu?! Mësymje është kjo?! Po të kalojmë nja tri pengesa të tilla, s'kemi për të vajtur kurrë në vendim e duhur.

Dhe u tërhoq zvarrë. Po, padashur, rënkoj.

— Ti je vrrarë shumë — i tha shoku tjetër.

— Ore, ne e harruam fare stërvitjen.

— Është mirë të qëndrosh këtu, Ismail — thashë unë me drojtje. Ai qeshi.

— Gjithnjë kështu ti. Sa keq je mësuar, vëlla i dashur! . .

— Po ti tani je i paaftë për luftim — i thashë.

— Nuk jam vrrarë. I plagosuri duhet të luftojë.

Dhe u zvarrit përpjetë, duke duruar dhembjet, pa pranuar ta lehtësonim nga ngarkesa e pajimeve luftarake. Më bëri me shenjë të kaloja nga e djathta. Unë ia zbatova urdhërin. Zvarritesha dhe mendoja për të. Nuk ndjeja as lodhje, as të ftohtë.

I ishim afruar objektit. Qetësi. Ai na pa të dyve. Bëri shenjë me kokë. Ne u hodhëm mbi mitralozin «armik». Dëgjova dhe një «ah» të tij. Ishte rënkimi nga dhembja e gjurit.

Bora zbardhte kudo. Era frynte. Unë e ndjeva veten të lehtë. Mezi prisja të ktheheshim në repart, jo që të pushoja, siç mendoja gjithnjë, por që të punoja stendën e emulacionit në dhomën e kulturës.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Tre shokë	3
Holta	28
Hijet	38
Nesimi	46
Plagë të së kaluarës	53
Në çadrën e tretë një ushtar nuk fle	62
Partizania e çetës sonë	70
Artistët	75
Lumturia	80
Mësim nga një natë	91